



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

PROJEKT-VENDIM

NR. 01, DATË 27 / 05 / 2025

**PER MIRATIMIN E “PLANIT LOKAL TE MENAXHIMIT TE INTEGRUAR TE
MBETJEVE TE NGURTA URBANE 2025-2030” NË BASHKINË Diber**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, neni 23, pika 12, dhe neni 54, pika k, si dhe Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, bazuar në relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Diber, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Diber:

KERKOJME:

1. Miratohet Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane 2025–2030 për Bashkinë Diber, sipas dokumentit bashkëlidhur, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Financës, si dhe Sektori i Menaxhimit të Mbetjeve dhe Gjelbërimit në Bashkinë Diber.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Bashkiak dhe pas konfirmimit të bazueshmërisë ligjore nga Institucioni i Prefektit.

PER BASHKINE DIBER

Drejtori Juridik

Ismet SARAÇI

Drejtorja e Financës

Çiljeta ZUNA

Drejtori i shërbime publike

Bedri KAMBERI

KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHIU

Me urdhër dhe me porosi

Zëvendëskryetar

Lorenç CIBAKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

RELACION

**Mbi Draft Planin e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane në Bashkinë Dibër
(2025–2030)**

Hyrje dhe Qëllimi i Relacionit

Ky relacion i paraqitet Këshillit Bashkiak të Dibrës si një dokument shpjegues dhe argumentues për Draft Planin e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane (2025–2030). Hartimi i këtij plani përfaqëson një domosdoshmëri ligjore dhe institucionale, por mbi të gjitha një instrument strategjik për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve, rritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Plani është përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, si dhe me Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve (SKM) dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve (PKMM). Ai harmonizohet gjithashtu me politikat e Bashkimit Europian, ku Shqipëria synon përafrimin e legjislacionit dhe praktikave për mbrojtjen e mjedisit.

Hartimi i tij u mundësua me mbështetjen e projektit “Bashki të Forta” të Helvetas Swiss Intercooperation, duke u ndërtuar mbi një proces konsultativ me aktorët institucionalë, komunitetin dhe ekspertët teknikë.

Draft Plani i Bashkisë Dibër është në përputhje me kuadrin kombëtar dhe ndërkombëtar të menaxhimit të mbetjeve. Politikat kombëtare bazohen mbi katër shtylla:

1. Planifikimi dhe integrimi strategjik – çdo bashki harton plane lokale të menaxhimit të mbetjeve.
2. Edukimi dhe ndërgjegjësimi publik – përfshirja e qytetarëve në procesin e ndarjes dhe riciklimit.
3. Mbështetja financiare – sigurimi i burimeve për funksionimin e shërbimit dhe për investime.
4. Përafrimi ligjor me BE-në – aplikimi i parimit “ndotësi paguan” dhe “përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit”.

Në nivel lokal, Këshilli Bashkiak ka përgjegjësi për miratimin e buxhetit të pastrimit, nivelit të tarifave, rregulloreve dhe planit të menaxhimit.

Bashkia Dibër ka një sipërfaqe prej 937.88 km² dhe një popullsi prej rreth 76 mijë banorësh, nga të cilët mbi 90% jetojnë në zonat rurale. Shërbimi i pastrimit ofrohet në qytetin e Peshkopisë me mbulim 100%, ndërsa në njësitë administrative periferike ofrohet me frekuenca më të ulëta.

Sipas matjeve të vitit të fundit, në territorin e bashkisë gjenerohen rreth 9,425 ton mbetje/vit, të cilat depozitohen në venddepozitim të rehabilituar pranë qytetit.

Bashkia ka në dispozicion 430 kontenierë me kapacitet 1.1 m³, si dhe mjete transporti (2 automjete teknologjike dhe 2 mjete të hapura). Dezinfektimi dhe mirëmbajtja e kontenierëve bëhet disa herë në muaj.

Kostot e shërbimit për vitin 2024 ishin rreth 37.5 milion lekë, ndërsa të ardhurat nga tarifa e pastrimit vetëm 20.6 milion lekë, duke mbuluar 55% të shpenzimeve. Diferenca mbulohet nga buxheti i bashkisë dhe grante të pakushtëzuara.

- Mbledhja e mbetjeve kryhet kryesisht e përzier, pa ndarje në burim.
- Riciklimi është i papërhapur dhe mungon infrastruktura e kompostimit.
- Ka depozitime ilegale dhe djegie të mbetjeve në fshatra.
- Tarifat aktuale nuk mbulojnë koston reale të shërbimit.

Draft Plani i Bashkisë Dibër synon:

- Rritjen e mbulimit të shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin e bashkisë deri në vitin 2030.
- Vendosjen e ndarjes në burim për të paktën 30% të mbetjeve deri në vitin 2030.
- Krijimin e një sistemi funksional riciklimi dhe kompostimi, duke bashkëpunuar me sektorin privat dhe komunitetin.
- Rritjen e ndërgjegjësimit publik përmes fushatave edukative dhe përfshirjes së shkollave, OJF-ve dhe grupeve komunitare.
- Sigurimin e qëndrueshmërisë financiare përmes përmirësimit të mbledhjes së tarifës, rritjes graduale të saj dhe aksesit në fonde të qeverisë dhe donatorëve.

Plani i Veprimit parashikon:

1. Investime në infrastrukturë – shtim të kontenierëve, mjeteve transportuese dhe rehabilitimin e venddepozitimeve.
2. Skema riciklimi dhe ekonomie qarkulluese – vendosje të koshave të ndarë për plastikë, letër, qelq dhe mbetje organike; mbështetje për nisma komunitare dhe partneritete me biznesin riciklues.
3. Forcim të kontrollit dhe monitorimit – ndëshkim për depozitime ilegale dhe evidentim i mbetjeve voluminoze dhe inerte.
4. Edukimi dhe ndërgjegjësimi – trajnime për komunitetin, fushata publike dhe përfshirje të shkollave.
5. Skenarë alternativë – përfshirja e partneriteteve publike-private për menaxhimin e mbetjeve dhe zgjerimi i shërbimeve në zonat e largëta.


Draft Plani i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane për Bashkinë Dibër (2025–2030) është një dokument bazë që i jep drejtim afatgjatë menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve.

Ai:

- Siguron përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe standardet e BE-së.
- Adreson sfidat aktuale të bashkisë si mungesa e riciklimit dhe mosmbulimi i plotë financiar i shërbimit.
- Propozon një vizion të qartë për një qytet të pastër, me komunitet të ndërgjegjësuar dhe sistem të qëndrueshëm të mbetjeve.

Këshilli Bashkiak, duke miratuar këtë plan, jo vetëm që përmbush një detyrim ligjor, por edhe investon në një të ardhme më të pastër, më të shëndetshme dhe më të zhvilluar për Bashkinë Dibër.

Konceptoi: Ermat Stojku



Drejtori i shërbimeve publike

Bedri KAMBERI





Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



HELVETAS
ALBANIA

PLANI LOKAL I MENAXHIMIT
TË INTEGRUAR TË MBETJEVE
TË NGURTA URBANE

Bashkia Dibër

2025-2030

SHKURTIMET

- AKM: Agjensia Kombëtare e Mjedisit
- ARM: Agjensia Rajonale e Mjedisit
- BE: Bashkimi European
- ISHMPIU: Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit Pyjeve dhe Ujrave
- ISHSH: Inspektoriati Shtetëror i Shëndetësisë
- MB: Mbetjet nga Bizneset
- MBZHR: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- MF: Mbetjet nga Familjet
- MIE: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- MTM: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- NJA: Njësi Administrative
- NJQV: Njësi Qëndrore Vendore
- OJF: Organizata Jo Fitimprurëse
- PLMIMNU: Plan i Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane
- PKMM: Plan Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve
- PGM: Pikë Grumbullimi Mbetjesh
- PPP: Partneritet Publik Privat
- SKM: Strategjia Kombëtare e Mbetjeve
- VKM: Vendim i Këshillit të Ministrave
- ZAM: Zona e Administrimit të Mbetjeve

Tabela e përmbajtjes

TABLE OF CONTENTS

SHKURTIMET.....	2
1. HYRJE	4
2. IMPAKTI MJEDISOR I PMIM ‘25-30.....	6
3. STRUKTURA ADMINISTRATIVE.....	7
4. POLITIKAT KOMBËTARE DHE KUADRI LIGJOR.....	8
5. PËRSHKRIMI I KARAKTERISTIKAVE TË ZONËS	12
6. ORGANIZIMI I SHËRBIMIT	16
7. INDIKATORËT E PERFORMANCËS.....	22
8. ASPEKTET FINACIARE TE SHERBIMIT TE PASTRIMIT.....	25
9. PLANIFIKIMI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE 2025 – 2030	30
10. SHËRBIMET E MENAXHIMIT TË MBETJEVE.....	32
11. PLANI I FSHIRJES SË QYTETIT PESHKOPI (2025–2030).....	37
12. GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTI I MBETJEVE.....	39
13. SKENARËT E MUNDSHËM NE MENAXHIMIN E MBETJEVE.....	44
14. MENAXHIMI I RRYMAVE TË TJERA TË MBETJEVE.....	50
15. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL.....	50
16. NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK	51
17. RISHIKIMI I PLANIT	57
18. PLANI I VEPRIMIT.....	59

1. HYRJE

1.1 Rreth planit

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve (PMIM) Urbane për Bashkinë Dibër është hartuar në përputhje me qëllimet dhe afatet që parashikohen nga ligjet sektoriale të vendit, përfshirë Strategjinë Kombëtare dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. Gjithashtu, përgatitja e këtij plani është në përputhje me afatin e rishikimit të planit pararendës të menaxhimit të mbetjeve të Bashkisë Dibër. Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve i cili është aprovuar nga Parlamenti në fund të nëntorit 2011, adapton plotësisht direktivat e BE-së (75/442/EEC), si dhe përcakton njëherazi hierarkinë e autoriteteve në menaxhimin e mbetjeve, duke ngarkuar me përgjegjësi bashkitë për të hartuar, miratuar dhe zbatuar Planin Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.

Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PVMMNB) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel Vendor, si një dokument/ udhëzues i rëndësishëm për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Dibër.

Ky plan mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qëndrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për menaxhimin e mbetjeve në nivel Vendor.

Dokumenti i parashtruar është në vazhdimësi të planit të mëparshëm, të miratuar në vitin 2017, i cili është shtylla mbi të cilën është ndërtuar plani i viti 2025-2030. Analiza e gjendjes fillestare ka për qëllim të kuptojmë se deri në çfarë mase janë realizuar objektivat e planit pararendës 2017-2021, si është situata aktuale, cilat janë problematikat e hasura dhe nevojat e evidentuara për ndërhyrje.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i gjendjes aktuale të shërbimit të largimit të mbetjeve të ngurta urbane, do të rishikohen dhe do të përcaktohen qëllime dhe objektiva për një shërbim cilësor duke realizuar sistemin e matjes së performancës, duke hartuar një plan të detajuar teknik dhe financiar, si dhe në fund duke monitoruar dhe bërë vlerësimin e situatës sipas protokollit të Monitorimit dhe Vlerësimit (M&V).

Ky plan përcakton mënyrën sipas së cilës do të ushtrohet dhe shtrihet funksioni i menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Dibër. PMIM ofron zgjidhje lokale gjerësisht të pranueshme dhe një kuadër të miratuar pune, sipas të cilit mund të merren vendime lidhur me infrastrukturën që nevojitet për të përmbushur zbatimin e praktikave më të mira mjedisore. Planin nxit një pjesëmarrje më të mirë të gjitha palëve dhe paraqet një këndvështrim strategjik të menaxhimit të mbetjeve, duke e vënë theksin në zgjerimin e zonës së shërbimit, në sasinë në rritje të mbetjeve dhe lehtësirat e nevojshme për menaxhimin e mbetjeve.

Gjithashtu, plani përfshin:

- Vlerësim të gjendjes aktuale të shërbimit të largimit të mbetjeve të ngurta urbane;
- Qëllimin dhe objektivat për shërbim cilësor të menaxhimit të mbetjeve;
- Sistemi i matjes së performancës;
- Një plan të detajuar teknik dhe financiar për menaxhimin e integruar të mbetjeve; dhe,
- Protokollin e monitorimit dhe vlerësimit (M&V)

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve do të mbulojë hapsirën kohore 2025 - 2030.

Ky plan është bazuar në Planin për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të bashkisë Dibër 2017-2021, me mbështetjen e DLDP, në analizën e thelluar të gjendjes aktuale realizuar nga Bashkia Dibër me ndihmën e mbështetjes së Bashkisë Forta.

1.2 Qëllimi i planit

Qëllimi dhe parimet e bashkisë Dibër për menaxhimin e mbetjeve burojnë nga legjislacioni në fuqi dhe ambicia e Shqipërisë për tu afruar me standardet evropiane në përputhje me Direktivat respektive të BE në këtë fushë.

Objekti i këtij plani janë mbetjet e ngurta bashkiake, të cilat përgjithësisht përcaktohen si mbeturina shtëpiake, mbeturina të ngurta të parrezikshme të aktivitetit tregtar, institucioneve, tregjeve, mbeturina nga oborret dhe nga fshirja e rrugëve. Menaxhimi i Mbetjeve përmbledh aktivitetet grumbullimin, transportin dhe depozitimin e tyre.

Qëllimi i bashkisë Dibër, do të përmbledhet si në vijim:

“Bashkia Dibër ka si qëllim të realizojë një shërbim efektiv dhe eficient, për të gjithë banorët dhe ta shtrirë në të gjithë territorin me një standard të përballueshëm prej qytetarëve në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e mjedisit dhe të mbrojë shëndetin e qytetarëve duke garantuar cilësi më të mirë për jetën dhe aktivitetin e banorëve, të mbështesë një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, me fokus në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, duke përmbushur kriteret për të ndihmuar rrugën drejt integritetit evropian të vendit.”

Më konkretisht, ky plan ka si qëllim të mundësojë dhe të sigurojë si më poshtë:

- *Përputhshmëri maksimale me Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve (SKM) dhe objektivat e saj:* duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe në arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve;
- *Variantet e menaxhimit të mbetjeve:* për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me objektivat kombëtare. Plani identifikon fushat dhe teknologjitë e duhura për minimizimin dhe depozitimin (asgjësimin) final të mbetjeve
- *Nevojat financiare për investime:* duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe ato për investime, me qëllim zbatimin e skemave të grumbullimit dhe të trajtimit të mbetjeve;
- *Burimet financiare për investime:* duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbetjet, sikurse dhe fonde nga institucionet ndërkombëtare;

2. IMPAKTI MJEDISOR I PMIM 25-30

Zbatimi i Planit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve do të përmirësojë në mënyrë të konsiderueshme impaktin mjedisor nga mbetjet në të gjithë territorin e bashkisë nëpërmjet:

Zvogëlimit maksimalisht të hedhjes së mbetjeve në mënyrë të pakontrolluar në natyrë dhe veçanërisht në rrjedhat ujore sipërfaqësore;

Mbrojtjen e vendbanimeve, zonave turistike dhe ekosistemeve nga depozitimi i pakontrolluar i mbetjeve në natyrë.

Në bashkëpunim me të gjithë aktorët, adaptimi i praktikave të mira, efëiente dhe të realizueshme për rikuperimin e burimeve të vlefshme nëpërmjet riciklimit dhe kompostimit dhe reduktimin e mbetjeve që depozitohen përfundimisht në venddepozitim;

Në mënyrë të veçantë menaxhimi i integruar i mbetjeve në bashkinë Dibrë do të ndikojë në:

- **Flora, Fauna dhe Biodiversiteti:** Territori i Bashkisë së Dibrës është i pasur me biodiversitet të larmishëm, falë relievit malor dhe klimës së ndryshme. Zona përfshin male si Korabi dhe Lura, me lartësi mbi 2,700 metra, që krijojnë kushte ideale për shumë specie të florës dhe faunës. **Flora:** Pyje të dendura me ah, bredh, dhe pisha; zona alpine me bimësi endemike. **Fauna:** Dibrës i përket specitë të mbrojtura si ariu i murrmë, kaprolli, ujku dhe shqiponja e malit. **Biodiversiteti:** Zona të mbrojtura si Parku Kombëtar i Lurës dhe burime të pasura ujore si lumi Drin, që mbështesin ekosisteme të ndërlikuara.

- **Peizazhi dhe aspekti vizual:** Çështja kryesore lidhur me këtë aspekt do të jetë aspekti vizual që japin pastërtia nga mbetjet dhe veçanërisht eliminimi i grumbullimeve të pakontrolluara të mbetjeve. Standardi i shërbimit, shpërndarja dhe cilësia e kontenerëve, do të krijojnë mundësinë e eliminimit të vend depozitimeve të pakontrolluar, rrjedhimisht do të përmirësojnë peizazhin dhe aspektin vizual nga mbetjeve e shpërndara në territor.

--**Ekonomia dhe jetesa:** Baza e ekonomisë dhe jetesa sigurohen nga turizmi, atraksioni i burimeve natyrore dhe ekonomia bujqësore. Dibrë është kthyer në një qendër të atraksionit kulinar mbi bazën e prodhimeve bio. Këto burime rrezikohen nga administrimi irracional i mbetjeve. Kontrolli mbi grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve ashtu siç propozohen në këtë Plan, kanë për synim që të sigurojnë një mjedis të pastër dhe atraktiv i cili mbështetet në zhvillimin e qëndrueshëm dhe miqësor ndaj mjedisit.

-**Shëndeti dhe siguria e komunitetit:** Shëndeti dhe siguria e banorëve të Dibrës mund të ndikohet nga mënyra se si grumbullohen, transportohen dhe trajtohen mbetjet. Standardi i grumbullimit dhe transportit, si dhe mjetet që kërkohen në zbatim të Planit japin siguri për ruajtjen e shëndetit, minimizimin e ndotjes së ajrit dhe zhurmave.

Në kuadër të ruajtjes së mjedisit dhe minimizimit të ndikimeve negative që mund të shkaktohen nga keqkuptimi dhe keqmenaxhimi i mbetjeve, është e domosdoshme të rritet ndërgjegjësimi i banorëve në zonat rurale të bashkisë. Edukimi dhe informimi i komunitetit mbi rëndësinë e ndarjes së mbetjeve, riciklimit dhe ripërdorimit është një hap kyç për të parandaluar ndotjen dhe për të mbrojtur natyrën. Jo çdo gjë që hidhet është mbetje — shumë materiale mund të kenë vlerë të dytë, të ripërdoren apo të shndërrohen në burime të dobishme. Prandaj, para se të ndërmerren iniciativa të mëdha infrastrukturore, është e rëndësishme që të zhvillohen fushata sensibilizuese që përputhen me legjislacionin shqiptar dhe me standardet ndërkombëtare për edukimin mjedisor, si dhe me konventat që Republika e Shqipërisë ka ratifikuar.

3. STRUKTURA ADMINISTRATIVE

3.1 Palët e përfshira, roli dhe përgjegjësitë

Në kuadër të përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve urbane, Bashkia Dibër ka rishikuar Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane, me mbështetjen e projektit “Bashki të Forta” të Helvetas Swiss Intercooperation.

Pas më shumë se 5 vjetësh nga miratimi i planit të vitit 2017, u angazhua një grup pune me përfaqësues të bashkisë, ekspertë dhe përfaqësues të Helvetas. Ky grup shqyrtoi opsionet ekonomike dhe mjedisore në përputhje me buxhetin dhe legjislacionin vendor. Procesi u zhvillua përmes takimeve dhe punëtorive, duke përfshirë diagnostikimin e gjendjes ekzistuese, përcaktimin e objektivave, identifikimin e skenarëve dhe hartimin e planit përfundimtar.

Bashkia Dibër, me përvojë të gjatë në këtë fushë, përfitoi nga mbështetja teknike e Helvetas për të gjitha njësitet administrative. Konsultimi me komunitetin siguroi që nevojat dhe prioritetet lokale të pasqyroheshin në planin përfundimtar.

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane është një përgjegjësi e ndare midis disa palesh siç janë, familjet, bizneset, zyra dhe institucione mbetjet e të cilëve janë të ngjashme me ato të gjeneruara në ambientet e shtëpive. Palët e përfshira dhe përfituesit direkt në këtë proces janë njësitet familjare, komuniteti i biznesit dhe autoritetet vendore e qendrore në Dibrë. Performanca e çdo pale në këtë proces do të ndikojë në rezultate pozitive për afrimin drejt menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve i cili do të ulë ndjeshëm sasinë e mbetjeve të cilat përfundojnë në depozitimin final, rrjedhimisht dhe në uljen e kostove të transportit. Për këtë arsye njësitet familjare, bizneset dhe institucionet dhe të gjitha palët e tjera inkurajohen të marrin mbi vete përgjegjësitë të cilat vijnë me gjenerimin e mbetjeve për të mbrojtur shëndetin dhe mjedisin e përbashkët.

Përgjegjësitë e të gjithë palëve dhe përfituesve ndër të tjera, përfshijnë:

- Reduktimin në masën me të madhe të mundshme të gjenerimit të mbetjeve;
- Ndarjen në burim të mbetjeve të njoma (biodegradueshme) nga ato të thata (riciklueshme);
- Bashkëpunimi me autoritetet vendore duke i hedhur mbetjet në kontenerët e duhur sipas instruksioneve të marra nga autoritetet përkatëse, duke respektuar kohën dhe vendin, si dhe duke paguar tarifën e shërbimit;

Megjithëse përfituesit e shërbimit kanë përgjegjësi të kufizuar deri në momentin e dorëzimit të mbetjeve në Pikat e Grumbullimit të Mbetjeve (PGM), përgjegjësia kryesore për menaxhimin e mëtejshëm të tyre i takon sektorit të menaxhimit të mbetjeve brenda strukturave të bashkisë. Ky sektor është përgjegjës për parandalimin e shpërndarjes së mbetjeve, si dhe për sigurimin që ato të transportohen dhe të depozitohen në pika të autorizuar për trajtim apo eliminim. Në këtë kontekst, bashkia ka detyrimin të mbikëqyrë dhe të monitorojë të gjithë zinxhirin e menaxhimit të mbetjeve, deri në destinacionin final të trajtimit PGM-të. Sipas Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, autoritetet vendore janë të obliguara të sigurojnë menaxhimin efikas dhe të qëndrueshëm të mbetjeve të ngurta urbane, duke respektuar standardet mjedisore dhe shëndetësore.

4. POLITIKAT KOMBËTARE DHE KUADRI LIGJOR

4.1 Politika dhe Strategjia Kombëtare për mbetjet

Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 1, Datë 13.01.2020, përcakton politikën e menaxhimit të programit të mbetjeve, që synojnë zhvillimin e menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit sipas direktivave të BE-së. Ky plan orienton politikën kryesisht në sigurimin e shërbimeve të qëndrueshme për MMN në të gjithë vendin, pakësimin dhe riciklimin e fraksioneve të mbetjeve, zvogëlimin e numrit të vend depozitimeve të pakontrolluara dhe jo sanitare, si dhe për mbrojtjen e mjedisit. Strategjia kombëtare e mbetjeve paracakton katër shtylla kryesore me qëllim zbatimin e politikës dhe të strategjisë së mbetjeve nëpërmjet **Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta**. Këto shtylla politike janë thelbësore dhe shumë të rëndësishme për të garantuar qëndrueshmërinë dhe suksesin e të gjithë menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri.

Shtyllat politike janë si në vazhdim:

Planifikimi	Edukimi	Mbështetja financiare	Forcimi i kuadrit ligjor
Hapi i parë në zbatimin e procesit duhet të jetë zhvillimi i planeve për të çuar përpara axhendën e strategjisë dhe të politikës së mbetjeve në lidhje me zbatimin.	Partnerët/bashkë-punëtorët kryesorë të sistemit duhet të edukohen në mënyrë që të përmbushin potencialin e tyre brenda sistemit dhe të lehtësojnë zbatimin e reformave.	Burimet njerëzore dhe vetë sistemi duhet të mbështeten financiarisht në mënyrën e duhur.	Sistemi kërkon një paketë rregulloresh. Për më tepër, për të siguruar hyrjen në Bashkimin Evropian, vendi do të duhet të bëjë përafrimin me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian në fushën e mjedisit, në vitet në vijim.

Gjithashtu ky plan thekson edhe faktin se nuk ka një sistem standard grumbullimi që mund të zbatohet në të gjithë vendin.

Për këtë arsye, në hartimin e planeve vendore të secilës bashki, duhet të merren në konsideratë shumë faktorë për përzgjedhjen e sistemit më të përshtatshëm të grumbullimit:

- Norma e gjenerimit të mbetjeve dhe përbërja e mbetjeve;
- Stuktura e banimit;
- Gjendja e rrugëve dhe hapësirave të disponueshme në anë të rrugëve dhe në zonat publike;
- Zakonet e banorëve;
- Teknologjitë e disponueshme në vend dhe mundësitë e mirëmbajtjes në rajon të pajisjeve të veçanta.

Parimet themelore për menaxhimin e mbetjeve përfshijnë:

Hierarkia e mbetjeve –Parandalimi dhe ripërdorimi si alternativa më të preferuara.

Parimi reduktues– Minimizimi i gjenerimit të mbetjeve.

Parimi parandalues – Reduktimi i ndikimit në shëndet dhe mjedis.

Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë – Trajtimi sa më afër vendit të prodhimit.

Parimi “Ndotësi paguan” dhe “Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit”– Prodhuesit mbulojnë kostot e mbetjeve që gjenerojnë dhe ky koncept zgjeron përgjegjësinë e prodhuesit përtej fazës së prodhimit, duke e përfshirë edhe **menaxhimin e mbetjeve të produkteve të tyre pas përdorimit**

Ligji 10463/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" është legjislacioni bazë që përcakton përgjegjësitë e institucioneve qendrore në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Ky ligj është përafëruar plotësisht me Direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008 “Mbi mbetjet”.

Ligji 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, përcakton funksionet e qeverisjes vendore, përfshirë funksionin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta (neni 23 pika 10).

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 319, datë 31.5.2018 Për Miratimin e Masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, është baza kryesore për llogaritjen e kostove dhe të tarifave për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve urbane.

Përveç kësaj, akte të tjera ligjore, të cilat janë zhvilluar më vonë për zbatimin e ligjit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, kanë përgjegjësi të detajuara institucionale ndërmjet institucioneve të qeverisë qendrore, duke përfshirë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe disa ministri të tjera, roli i të cilave lidhet me rryma të veçanta të mbetjeve.

Duke qenë se ky dokument kufizohet në menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane dhe rrymave specifike që këto mbetje përmbajnë, në vijim është përshkruar kuadri institucional i atyre institucioneve në nivel qendror të cilat kanë lidhje drejtpërdrejt me këtë rrymë.

Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta

Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, nr. 10 463, datë 22.09.2011, i ndryshuar, është aprovuar nga Kuvendi i Shqipërisë në fund të shtatorit 2011.

Ligji adapton plotësisht shumicën e direktivave dhe rregulloret e BE-së, dhe siguron bazën e duhur ligjore për përshtatjen e plotë të gjithë legjislacionit të BE-së në sektorin e menaxhimit të mbetjeve.

Përgjegjësia për Menaxhimin e Mbetjeve

Neni 20 përcakton se shpenzimet për menaxhimin e integruar të mbetjeve mbulohen bazuar në parimin "ndotësi paguan", përveç rastit kur Këshilli i Ministrave apo këshillat vendore vendosin që pjesë të kostos apo gjithë kosto mbulohen nga të tjerë që nuk janë gjeneruesit fillestare të mbetjeve.

Për më tepër i njëjti ligj parashikon ndarjen e autoritetit, funksionet, rolet dhe përgjegjësitë, nga lartë - poshtë, nga qeveria qendrore tek njësitë e qeverisjes vendore.

Në veçanti, ligji ngarkon njësitë e qeverisjes vendore me sa më poshtë:

- i. Të miratojë një plan të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Planin e Menaxhimit të Mbetjeve të Qarkut,
- ii. Të miratojë rregullat e kontrollit të menaxhimit të mbetjeve të veçanta, duke përfshirë letrën dhe kartonin, qelqin, ushqim dhe kontejnerëve të pijeve, metalin, plastikën apo mbetjet e oborrit,
- iii. Të raportojë çdo vit në qarkun përkatës dhe institucione të tjera për zbatimin e planit të menaxhimit të mbetjeve vendore,

- iv. Të publikojë një draft të Planit dhe ta vere atë në dispozicion të publikut përmes faqes së internetit të qeverisjes vendore,
- v. Të miratojë Planin përkatës duke marrë në konsideratë rezultatet e çdo Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM), përpara miratimit të saj.

Neni 10 i Ligjit parashikon se Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve miratohet në përputhje me objektivat dhe parimet e mbrojtjes së mjedisit të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe të Planeve Rajonale dhe Lokale të Menaxhimit të Mbetjeve. Neni 15 parashikon se Komiteti për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve do të krijohet në nivel kombëtar, dhe do të jetë përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e menaxhimit të mbetjeve në shkallë kombëtare.

4.2 Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta

Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta (Strategjia), miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 1, Datë 13.01.2020, përcakton politikat e menaxhimit të programit të mbetjeve, që synojnë zhvillimin e menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit sipas direktivave të BE-së. Ky plan orienton politikat kryesisht në sigurimin e shërbimeve të qëndrueshme për MMN në të gjithë vendin, pakësimin dhe riciklimin e fraksioneve të mbetjeve, zvogëlimin e numrit të vend depozitimeve të pakontrolluara dhe jo sanitare, si dhe për mbrojtjen e mjedisit.

Sipas këtij plani, masat e nevojshme infrastrukturore vendore në zonën e mbetjeve Shkodër - Dibër për të garantuar menaxhim modern, të integruar të mbetjeve, janë:

- Garantim i grumbullimit të qëndrueshëm të mbetjeve në nivel vendor/ bashkiak në të gjithë zonën e mbetjeve
- Garantim i mbylljes dhe rehabilitimit të duhur të vendgrumbullimeve ekzistuese në zonën e mbetjeve

Gjithashtu ky plan thekson edhe faktin se nuk ka një sistem standard grumbullimi që mund të zbatohet në të gjithë vendin. Për këtë arsye, në hartimin e planeve vendore të secilës bashki, duhet të merren në konsideratë shumë faktorë për përzgjedhjen e sistemit më të përshtatshëm të grumbullimit:

- Norma e gjenerimit të mbetjeve dhe përbërja e mbetjeve;
- Stuktura e banimit, hapësirë e disponueshme brenda banesave/apartamenteve;
- Gjendja e rrugëve dhe hapësirave të disponueshme në anë të rrugëve dhe në zonat publike;
- Zakonet e banorëve;
- Teknologjitë e disponueshme në vend dhe mundësitë e mirëmbajtjes në rajon të pajisjeve të veçanta.

Vkm Nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”,

Vkm Nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve” përcakton:

1. Miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe jep udhëzuesin për llogaritjen e kostove për menaxhimin e mbetjeve" dhe "Modelet për llogaritjen e tarifave për:

- a) menaxhimin e mbetjeve", përkatësisht, shtojcat 1 dhe 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
- b) Udhëzuesi dhe modelet, sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij vendimi, do t'u shërbejnë njësive të vetëqeverisjes vendore, duke u bazuar në numrin e banorëve dhe të familjeve që kanë në territoret e tyre, sipas ndarjes administrative.

Standardet e Komunitetit Evropian

Kuadri i direktivës së mbetjeve është legjislati i gjithëpërfshirës nga Bashkimi Evropian që kanë të bëjnë me mbetjet. Direktiva 2008/98/EC mbi mbetjet e miratuar në nëntor 2008 parasheh një qasje të re të menaxhimit të mbetjeve bazuar në parandalimin e ndikimeve negative të gjenerimit të mbetjeve dhe menaxhimit për ruajtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit, dhe synon kufizimin e prodhimit të mbetjeve si dhe inkurajon përdorimin e mbetjeve si burim përmes riciklimit dhe rikuperimit. Në mënyrë për të arritur këtë qëllim, Direktiva Evropiane ka vendosur si prioritet hierarkinë në vijim për menaxhimin e mbetjeve:

- i. Parandalim
- ii. Përgatitja për ripërdorim
- iii. Riciklimit
- iv. Rikuperime të tjera, p.sh. burim energjie
- v. Asgjëimi

5. PËRSHIKRIMI I KARAKTERISTIKAVE TË ZONËS

5.1 Shtrirja gjeografike

Bashkia e Dibrës shtrihet në veri-lindje të Shqipërisë, në koordinatat gjeografike 41° e 53' dhe 20° e 34', në një territor me sipërfaqe 937.88 km². Peshkopia është qendra administrative dhe urbane e bashkisë dhe ndodhet në largësinë 44 km nga Lura, 36 km nga Kalaja e Dodës dhe 18 km nga pika kufitare e Bllatës. Këto zona janë skajet e këtij territori. Territori është rural në më shumë se 91% të sipërfaqes së tij.

Bashkia e Dibrës përbëhet nga një qytet (Peshkopia) dhe nga 141 fshatra, të cilat janë pjesë e 14 njësive administrative si: Lura, Zall-Reçi, Zall-Dardha, Selishta, Luzni, Muhurri, Arrasi, Fushë-Çidhna, Sillova, Kalaja e Dodës, Kastrioti, Tomini, Melani dhe Maqellara. Bashkia e Dibrës kufizohet me bashkinë e Kukësit në veri, me fshatrat e Matit dhe të Mirditës në jug, me fshatrat e Bulqizës në jug-lindje dhe me kufirin shtetëror të Maqedonisë në veri-lindje.

Relievi

Relievi i zonës është malor dhe dallohet për karakterin kompleks. Në përbërje të relievit gjejmë: kurrize malore, pllaja, gropa, fusha karstike si dhe malësi e lugina. Kjo malësi shtrihet nga 380 në 2751 m në skajin lindor. Mbizotërojnë malësitë mbi 700-900 m, që ulen gradualisht në drejtim të perëndimit. Në këtë malësi takohen tipa të relievit strukturo-eroziv, erozivo-dedunues, karstik, akullnajor. Territori i bashkisë Dibrë, në masën 90%, është zonë rurale dhe vetëm 10% e këtij territori është zonë urbane, që shtrihet në qytetin e Peshkopisë. Zona rurale përfaqësohet nga 141 fshatra me një diversitet relievi nga fshatra malorë, kodrinorë dhe fushorë, kryesisht në luginën e Drinit të Zi. Territori i zonës është kryesisht malor me 55% të territorit, kodrinor rreth 30% e territorit dhe 15% i territorit është fushor.


Klima

Përsa i përket tipareve klimaterike, territori i Dibrës, që shtrihet në pjesën e brendshme të vendit, ka klimë mesdhetare kontinentale. Si pjesë e zonës malore, ky territor karakterizohet nga sasi reshjesh mbi mesataren vjetore të vendit. Ato shkojnë deri në 980 mm. Temperaturat më të larta të vërejtura arrijnë 25° - 30°C në korrik, ndërkohë që temperaturat minimale gjatë dimrit arrijnë deri në -20°C. Orët vjetore me diell variojnë nga 2.100 dhe 2.300. Korriku dhe, disa here, gushti janë muajt më të thatë, ndërsa dhjetori dhe janari muajt më të ftohtë.

Hidrografia

Sistemi ujor në territorin e Dibrës përbëhet nga lumenj, përrenj, liqene dhe burime të tjera ujore. Lumi Drini i Zi përshkon gjithë territorin. Në të derdhen të gjithë përrenjtë, të cilët janë malorë me pjerrësi të lartë (>30%).

Midis pasurive të shumta vlejnë për t'u përmendur edhe liqenet shumë të bukura të Lurës, burimi i Ilixhave, si dhe disa burime të vogla në afërsi të qytetit. Pasuritë hidrike kanë ndihmuar jo pak në zhvillimin ekonomik të kësaj zone si në energji, ujitje, peshkim, industri, etj. Sistemi ujor përbëhet nga tërësia e burimeve nëntokësore dhe mbitokësore ujore, si dhe përmban të gjithë trupat ujorë, përfshirë brigjet, sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm. Gjithashtu, ka edhe një sërë rezervuaresh artificiale për nevoja ujitjeje (6 rezervuarë).



Harta 1: Rrjeti hidrografik i Bashkisë

5.2 Përbërja administrative e njësive

Të dhëna të përgjithshme

Bashkia e Dibrës është një nga bashkitë e reja me territorin më të madh në rang vendi, me një sipërfaqe prej 937.88 km².

Kjo bashki përbëhet nga 15 njësi administrative, të cilat janë: Peshkopi, Tomin, Melan, Kastriot, Lurë, Maqellarë, Muhurr, Luzni, Selishtë, Sllovë, Kala e Dodës, Zall-Dardhë, Zall-Reç, Fushë Çidhën dhe Arras. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Dibrës dhe qarkut të Dibrës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 141 fshatra.

Harta 2: Ndarja administrative e Bashkisë Dibrë



5.3 Popullsia


Popullsia e Bashkisë Dibrës vlerësohet të jetë 76,143 banorë. Qyteti i Peshkopisë është qendra urbane e zonës së Dibrës dhe ka popullsinë më të lartë, ndërsa popullsia tjetër banon në zonën rurale të Maqellarës, Melanit, Tominis, Kastriotit, Fushë-Çidhës, Slllovës, Kalasë së Dodës, Reçit, Zall-Dardhës, Arrasit, Muhurrit, Slllove, Selishtës dhe Lurës. Tabela e mëposhtme jep strukturën e popullsisë. Sipas Censurit të vitit 2023, bashkia e re ka një popullsi prej 61,619 banorësh, sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron rreth 75,545 banorë dhe sipas formulës të ministrisë së financave 66,815 banorë: (censusi 2023)

Nr. i popullsisë SIPAS G.J. Civile	76,143
Nr. i popullsisë INSTAT	61,619
Nr. Popullsisë MFE	66,815
Nr. popullsisë që merr shërbimin e grumbullimit të mbetjeve	66,622

5.3.1 Shpërndarja e popullsisë

Popullsia dominuese e zonës është ajo rurale, ndërsa pjesa e përkjet asaj urbane shumica është e përqëndruar në qytetin e Peshkopisë. Ashtu siç u shprehëm edhe më lart, popullsia si rurale edhe urbane ka pësuar rënie gjatë dy dekadave të fundit. Aktualisht, popullsia urbane përbën 25 % të totalit të popullsisë dhe ajo rurale 75%.

Shifra e popullsisë urbane ka qenë pak a shumë e qëndrueshme gjatë 2020-2025. Kjo zonë është karakterizuar nga një lëvizje e popullsisë rurale drejt qytetit të Peshkopisë, ky fenomen ka qenë më i theksuar gjatë viteve 2017-2023 edhe pse migrimi i brendshëm pritet të jetë një nga faktorët determinant në përcaktimin e morfologjisë demografike të zonës për vitet në vijim.



Harta 4: Densiteti i popullsisë (Bashkia Dibrë)

6. ORGANIZIMI I SHËRBIMIT

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve ofrohet nga vetë Bashkia. Në vitin 2025, sektori i menaxhimit të mbetjeve është i organizuar me një Drejtor Shërbimesh dhe një Sektor për Menaxhimin e Mbetjeve, gjë që përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të aspektit institucional të shërbimeve në një bashki më të madhe. Kjo sjell rritjen e qëndrueshmërisë institucionale të shërbimit, si në aspektin e burimeve njerëzore, ashtu edhe në ndarjen e buxhetit.

Konkretisht, Sektori i Menaxhimit të Mbetjeve në Bashkinë Dibër përbëhet si më poshtë:

- 1 Drejtor
- 1 Përgjegjës i pastrimit dhe gjelbërimit
- 3 punonjës zyre
- 1 Inspektor i njësive administrative
- 60 punonjës (shoferë dhe punonjës të transportit, punonjës të fshesës dhe punonjës të gjelbërimit)

Bashkia ka një plan të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane, të miratuar në vitin 2017 me mbështetjen e DLDP. Qyteti i Peshkopisë dhe NJA Maqellarë mbulohen me shërbim në masën 100%, ndërkohë që njësitë e tjera si Melan, Muhurr, Kastriot etj., pastrohen me një frekuencë më të ulët se qyteti, shërbimi bëhet derë më derë me thasë.

Mbetjet urbane grumbullohen dhe tërhiqen 2 herë në ditë në 7 ditë të javës në qytet, ndërsa në NJA Maqellarë 4 herë në javë nga kontenierët 1.1 m³ (rreth 250 copë). Kontenierët janë të pajisur me goma dhe dezinfektohen një herë në javë. Në disa fshatra, shërbimi bëhet derë më derë me thasë, ku mbetjet tërhiqen një herë në javë në një ditë të caktuar. Po ashtu, janë vendosur edhe kontenierë. Fshatrat që përfshihen në këtë shërbim janë:

- **NJA Maqellarë**, fshatrat: Pocest, Kërçisht, Kllobçisht, Pesjakë, Vojnik, Çernenë, Dovolani, Bllatë e Poshtme, Bllatë e Sipërme, Majtarë, etj.
- **NJA Tomini**, fshatrat: Tomini, Brezhdan, Cetush, Dohoshisht, Pilafe, Pollozhan, Rrashnapojë, Selane, Ushtelenxë, Staravec, Shimçan, Zdojan.
- **NJA Melan**, fshatrat: Grevë, Trenë, Pjeçë, Pejke, Trepçë, Begjunec, Rabdisht, Melan.
- **NJA Kastriot**, fshatrat: Kastriot, Brest i Sipërm, Brest i Poshtëm, Kishavec, Kandër, Kukaj, Vakuf, Fushë-Kastriot, Borovjan, Deshat, Limjan, Sohodoll, Sohodoll i Vogël, etj.
- **NJA Muhurr**, fshatrat: Muhurr, Fushë-Muhurr, Hurdhë-Muhurr, Rreth-Kale, Shqath, Vajmëdhej.
- **NJA Kala e Dodës**, menaxhohet nga vetë njësia administrative – dhe jemi në vazhdimësi për zgjerimin e mundshëm.
- **NJA Fushë-Çidhën**, fshatrat: Fushë-Çidhën, Bllaçë, Laçe, Rrenz.
- **NJA Sillove**, fshatrat: Shumbat, Sillove – dhe jemi në vazhdimësi për zgjerimin e mundshëm.


Sasia e mbetjeve që gjenerohen në Bashki llogaritet të jetë 9,425 ton/vit, sipas matjeve të kryera vitin e kaluar. Bashkia i dërgon mbetjet në venddepozitimin e kontrolluar dhe të rehabilituar, të përcaktuar në planin e menaxhimit, në unazën e re, në dalje të qytetit.


6.1 Infrastruktura

Bashkia Dibër ofron shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve me një infrastrukturë prej 366 kontenierësh 1.1 m³ me mekanizëm shkarkimi. Ata janë të vendosur në qytetin e Peshkopisë, NJA Tomin, NJA Kastriot, NJA Maqellarë, NJA Melan, NJA Muhurr dhe NJA Sillov.

Bashkia kujdeset për mirëmbajtjen dhe dezinfektimin e kontenierëve disa herë në muaj. Ndërkohë, për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, Bashkia ka në dispozicion:

- 2 mjete teknologjike
- 2 mjete të hapura





6.2 Zbatimi i hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve

Neni 4 i Direktivës Kuadër të BE-së për Mbetjet, i rishikuar (WFD (Direktiva 2008/98/EC), përcakton pesë hapa për trajtimin e mbetjeve në bazë të prioriteteve. Këto hapa formojnë bazën e hierarkisë së mbetjeve, e treguar edhe në figurën e mëposhtme, e cila ilustron rradhën e prioriteteve që duhet të merren parasysh në momentin e marrjes së vendimeve, përta i përket përdorimit të burimeve dhe gjenerimit të mbetjeve në territorin që secila bashki ka në administrim.

Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve është një udhëzues i pranuar kombëtar dhe ndërkombëtar, për t'i dhënë prioritet praktikave të menaxhimit të mbetjeve, me qëllim arritjen e rezultateve optimale mjedisore. Kjo hierarki përcakton rendin e preferuar të praktikave për menaxhimin e mbetjeve, nga më të preferuarat tek ato më pak të preferuara.



Politikat e mëposhtme janë zhvilluar dhe do të ndiqen gjatë zbatimit të planit, për të arritur rezultate të pranueshme, duke analizuar mundësitë e Bashkisë së Dibrës.

6.2.1 Shmangia



Procesi i shmangies së gjenerimit të mbetjeve në Dibër është akoma në një fazë shumë të hershme. Megjithatë, në nivel shkollash, individët do të edukohen për përdorimin e çantave prej cope gjatë blerjes së produkteve. Rezultatet e kësaj politike do të jenë të vështira për t'u matur, por mund të vëzhgohen.

6.2.2 Ripërdorimi

Ripërdorim

2 Ripërdorim i materialeve

Në Dibër është e lartë mundësia e ripërdorimit të materialeve, si për shembull shishet plastike, shishet e qelqit, kavanozët dhe enët, rrobat e vjetra, materialet e ndryshme të paketimit, druri dhe gomat. Të qënurit një bashki e varfër nga ana ekonomike, ripërdorimi i materialeve është shumë i rëndësishëm. Njerëzit përdorin shishet për të mbajtur ujin apo qumështin, ose enë qelqi për përdorime shtëpiake. I vetmi produkt paketimi, i cili mund të përdoret relativisht më pak, janë qeset e holla plastike.

Promovimi i ripërdorimit të materialeve është shumë i arritshëm dhe Bashkia do të sigurohet që ky proces të njihet sa më mirë nga individët dhe të zbatohet në nivele sa më të larta të mundshme. Hapi i parë drejt zbatimit të kësaj politike do të jetë ndërgjegjësimi i qytetarëve.

6.2.3 Riciklimi

Riciklim

3 Riciklimi i materialeve

Riciklimi, Kompostimi dhe Ekonomia Qarkulluese

Në territorin e Bashkisë Dibër nuk regjistrohen aktivitete të organizuara në lidhje me riciklimin dhe kompostimin në asnjë nga njësitë administrative. Qyteti i Peshkopisë nuk ka sistemin e vendosjes së 3 koshave, dhe Bashkia vazhdon të aplikojë sistemin e grumbullimit të mbetjeve vetëm në një kosh. I vetmi diferencim që zbatohet është në rastin e supermarketeve të mëdha, të cilat gjenerojnë mbetje voluminoze; për këtë arsye, Bashkia ka vendosur një kontener pranë biznesit të tyre për menaxhimin e këtyre mbetjeve, të cilat tërhiqen nga mjetet e saj.

Në të kaluarën, në pjesën urbane të qytetit ka pasur përpjekje për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme nga sektori i biznesit, por këto përpjekje nuk kanë arritur të kenë sukses të qëndrueshëm.

Forcimi i biznesit dhe industrisë së riciklimit në vend dhe në Bashkinë Dibër do të jetë një faktor i rëndësishëm, së bashku me aktorët kryesorë, për zhvillimin e skemave të riciklimit. Skema aktuale e grumbullimit të mbetjeve është klasike, ku mbetjet mblidhen dhe transportohen të përziera, pa ndjekur procesin e ndarjes, drejt venddepozitimit të përcaktuar.

Aktualisht, ndonëse në Bashkinë Dibër mund të ketë pasur kërkesa nga aktorë të rajoneve të tjera për të mbledhur disa fraksione të caktuara të mbetjeve të riciklueshme, popullsia egjiptiane është ajo që kryen një aktivitet të përditshëm informal në grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme nga PGM-të apo nga depozitimet ilegale në territor.

Ekonomia Qarkulluese dhe Iniciativat Komunitare

Përveç përpjekjeve institucionale, në territorin e Bashkisë Dibër janë evidentuar praktika të ekonomisë qarkulluese të mbështetura nga komuniteti dhe institucionet fetare. Në bashkëpunim me xhamitë dhe organizata lokale, është bërë e mundur që rroba të vjetra, orendi shtëpiake dhe pajisje të tjera të përdorura të mblidhen dhe të ri-përdoren nga qytetarët në nevojë. Kjo iniciativë jo vetëm që redukton sasinë e mbetjeve, por edhe promovon solidaritetin social dhe përdorimin efikas të burimeve ekzistuese.

Gjithashtu, në disa njesi administrative të Bashkisë kemi një praktikë pozitive e ndarjes në burim. Duke qenë se mbetjet mblidhen një herë në javë në një ditë të caktuar, banorët i vendosin mbetjet në thasë të veçantë dhe i dorëzojnë në pikën e grumbullimit duke bërë vetë diferencimin sipas llojit, duke shmangur përzierjen me mbetjet e gjelbra. Këto të fundit, të cilat më parë hidheshin pranë kontenierëve, tani trajtohen ndryshe, duke kontribuar në një menaxhim më të mirë të mbetjeve dhe në uljen e ndotjes vizuale dhe mjedisore.

6.3 Gjenerimi i mbetjeve dhe trajtimi i final i mbetjeve

Sasia e mbetjeve që gjenerohen në bashki llogaritet të jetë 9,425 ton/ vit, sipas matjeve të kryera vitin e shkuar. Bashkia i dërgon mbetjet në vendepozitim të kontrolluar dhe të rehabilituar, përcaktuar në planin e menaxhimit, në unazën e re, në dalje të qytetit.

7. INDIKATORËT E PERFORMANCËS

Në përfundim të procesit për evidentimin e gjendjes ekzistues të shërbimit në Bashkinë Dibër, u bë vlerësimi i performancës bazuar në indikatorët: i) Cilësia e shërbimit; ii) Qëndrueshmëria mjedisore; iii) Qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare. Secili nga tre indikatorët ka indikatorët e tij specifikë, të cilët u përdorën për llogaritjen e indikatorit kryesor, siç shpjegohet më poshtë:

Cilësia e shërbimit - Ky indikator përbëhet nga tre indikatorë specifikë.

- a. **C1** Mbulimi i zonës me shërbim: ky indikator tregon sasinë e mbetjeve të grumbulluara në NJA nga firma private e autorizuar ose nga njësi vetë (nëse e kryen ajo shërbimin) kundrejt sasisë totale të mbetjeve të gjeneruara në njësi:

$$C1 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen në zonë } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{\text{Sasia e mbetjeve që gjenerohen në zonë } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

- b. **C2:** Pastërtia e bashkisë: ky është një indikator gjithëpërfshirës, i cili vlerësohet nga tre kriterë vlerësimi:
- i. Efektiviteti i grumbullimit të mbetjeve (prezenca e mbetjeve të akumuara rreth PGM);
 - j. Efektiviteti i pastrimit të rrugëve (prezenca e mbetjeve në rrugë);
 - k. Efektiviteti i grumbullimit të mbetjeve në zonat e largëta (prezenca e mbetjeve të akumuluar/pika ilegale/ djegie të mbetjeve në rrugë).
- c. **C3:** Shkalla e kënaqësisë publike: ky është një indikator cilësor për shërbimin që ofron bashkia, dhe vlerësohet në sajë të pyetësorëve të ndryshëm me komunitetin. Zakonisht ky indikator llogaritet në sajë të një pyetje të vetme: **A jeni të kënaqur me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve që ofrohet në njësinë tuaj?**

Për vlerësimin e këtij indikator i kanë shërbyer fushatat e pyetësorëve dhe dëgjesta publike të zhvilluara nga bashkia

Qëndrueshmëria mjedisore - Ky indikator përbëhet nga dy indikatorë specifikë.

- a. **D1:** Shkalla e grumbullimit të diferencuar: ky indikator prezanton shkallën e sasisë të mbetjeve që grumbullohen të ndara kundrejt sasisë totale të mbetjeve të grumbulluara. Formula për llogaritjen e këtij indikator i jepet si më poshtë:

$$D1 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen të ndara në zonë } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen total në zonë } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

- b. **D2:** Shkalla e mbetjeve të trajtuara sipas normave: ky indikator shpreh sasinë e mbetjeve që trajtohen në impiante të autorizuar. Formula për llogaritjen e këtij indikator i jepet si më poshtë:

$$D2 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve që trajtohen në impiante } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen total } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare: Ky indikator përbëhet nga tre indikatorë specifikë.

- a. **E1 - Mbulimi i Kostos:** ky indikator mat sa kosto e plotë e shërbimit e mbuluar nga grumbullimi i tarifave. Formula më poshtë tregon se llogaritet ky indikator:

$$E1 = \frac{\text{Të ardhurat nga tarifa e mbetjeve } \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)}{\text{Kosto totale e shërbimit } \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$


- b. **E2 - Shkalla e mbledhjes së tarifës:** ky indikator reflekton kapacitetin e popullsisë për të paguar tarifën. Formula për llogaritjen e këtij indikator i jepet në formulën më poshtë:

$$E2 = \frac{\text{Të ardhurat vjetore nga tarifa e pastrimit} \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}} \right)}{\text{Totali i të ardhurave të planifikuara} \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}} \right)} \times 100$$

- c. **E3 - Transparenca në systemin e faturimit:** ky është një indikator cilësor, i cili ka tre shkallë vlerësimi:
- I ulët: nuk ka një sistem faturimi për tarifën e pastrimit
 - Mesatar: ka një sistem faturimi dhe konsumatori merr një faturë
 - I lartë: ka një sistem faturimi dhe konsumatori ka informacion dhe kupton tarifën e llogaritur dhe mënyra e llogaritjes është e qartë dhe transparente për të gjithë komunitetin

Më poshte jepen rezultat e vlerësimit të gjendjes ekzistuese sipas indikatorëve të performancës në Bashkinë Dibrë:

INDIKATORI 1: Niveli i mbulimit të zonës me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve




INDIKATORI 2: Shkalla e grumbullimit të nadrë të mbetjeve sipas kategorive të veçanta

Bashkia Dibrë **nuk kryen grumbullim** të ndarë të mbetjeve sipas kategorive të veçanta


INDIKATORI 3: Shkalla e mbetjeve të trajtuara sipas normave (në impiante sanitare ose vend depozitime të kontrolluara)

Bashkia Dibrë **nuk i depoziton** mbetjeve e grumbulluara në një venddepozitim të kontrolluar apo impiant sanitar

INDIKATORI 4: Mbulimi i kostos së shërbimit nga realizimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit



INDIKATORI 5: Niveli i grumbullimit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit kundrejt planifikimit të të ardhurave nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve



8. ASPEKTET FINACIARE TE SHËRBIMIT TE PASTRIMIT

1 Buxheti i shërbimit të pastrimit

Bazura në të dhënat e mundësuar nga bashkia Dibër për vitin 2022 dhe 2024, (në tabelën më poshtë jepet një përmbledhje e shpenzimeve faktike për shërbimin e pastrimit dhe realizimi i të ardhurave nga kategoritë e konsumatorëve:

Realizimi faktik i buxhetit të mbetjeve (kosto operative/ vlera e kontrëtës së shërbimit (lek/vit) FAKT	23,695,404 Lekë
Planifikimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit (lek/vit)	19,950,000 Lekë
Planifikimi i të ardhurave nga familjet (lek/vit)	7,500,000 Lekë
Planifikimi i të ardhurave nga bizneset dhe institucionet (lek/vit)	12,450,000 Lekë
Realizimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit (lek/vit)	15,421,048 Lekë
Realizimi i të ardhurave nga familjet (lek/vit)	2,880,470 Lekë
Realizimi i të ardhurave nga bizneset dhe institucionet (lek/vit)	12,540,578 Lekë

2 Tabela 2 Buxheti i shërbimit të pastrimit dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Dibër për vitin 2022

Realizimi faktik i buxhetit të mbetjeve (kosto operative/ vlera e kontrëtës së shërbimit (lek/vit) FAKT	37.508.056 Lekë
Planifikimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit (lek/vit)	28.465.000 Lekë
Planifikimi i të ardhurave nga familjet (lek/vit)	12.000.000 Lekë
Planifikimi i të ardhurave nga bizneset dhe institucionet (lek/vit)	15.465.000 Lekë
Realizimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit (lek/vit)	20.688.201Lekë
Realizimi i të ardhurave nga familjet (lek/vit)	7.926.469Lekë
Realizimi i të ardhurave nga bizneset dhe institucionet (lek/vit)	12,761,750 Lekë

Tabela 3: Buxheti i shërbimit të pastrimit dhe realizimi i të ardhurave në bashkinë Dibër për vitin 2024

Siç mund ta shohim edhe nga vlerat, të ardhurat e grumbulluara nga tarifa e pastrimit mbulojnë vetëm

55% të Kostos së shërbimit në Bashkinë Dibër për vitin 2024

KATEGORITE	Peshkopi	Peshkopi	4 Njësitë	4 Njësitë	10 Njësitë	10 Njësitë	Të gjitha njësitë
	BV	BM	BV	BM	BV	BM	BV me TVSH
Kategoria Familje	2,200		1,600		1,100		
Kategoria Biznes							
<i>Shitje me pakicë/shumicë (TREGTI)</i>							
Fruta perime,ushqimore,mish,peshk	10,000	30,000	10,000	30,000	5,000	30,000	20,000
Artikuj industriale(veshje,parfumeri,argjendari etj)	8,000	30,000	8,000	30,000	4,000	30,000	15,000
Pub,diskoteka,lojëra fati	20,000	30,000	20,000	30,000	10,000	30,000	20,000
Bar kafe,Fast food,kafe internet etj	8,000	30,000	8,000	30,000	4,000	30,000	15,000
Bar restorant,hotel,motel,komplekse turistike	10,000	30,000	10,000	30,000	5,000	30,000	20,000
Shitje produktesh farmaceutike,depo farmaceutike dhe të ngjashme me to	8,000	30,000	8,000	30,000	4,000	30,000	15,000
<i>Njësi Prodhimi</i>							
Përpunimduralumini,Metalesh,druri,tapicerie,le tre,kartoni,plasmasi etj, Të ngjashme me to	15,000	30,000	15,000	30,000	7,500	30,000	20,000
Impiante,territore për therjen e kafshëve etj, Të ngjashme me to	10,000	20,000	10,000	20,000	5,000	20,000	15,000
Prodhime ushqimore,buke,ëmbëlsirash,mishi,peshku,bul meti,pijesh etj, Të ngjashme me to		30,000	15,000	30,000			
<i>Subjekte Ndërtimi</i>							
Subjekte ndërtuese për selinë administrative	20,000	50,000	20,000	50,000	20,000	50,000	30,000

Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 141 fshatra. Gjatë përgatitjes së paketës fiskale u konsideruan tre grupe administrative:

1. Grupi 1 – Njësia Administrative Peshkopi, Zona A
2. Grupi 2 – 4 Njësi Administrative (Maqellarë,Tomin,Melan,Kastriot),Zona B
3. Grupi 3-- 10 Njësi Administrative (Muhur, Sillove, Selishtë, Arras, Lurë, Zall Dardhë,Zall-Rec, Sillovë, Fushë-Cidhën, Kala e Dodës), Zona C

Kjo ndarje është bërë në bazë të situatës ekonomike të Njësive Administrative dhe shërbimeve të ofruara drejtpërsëdrejti nga pushteti lokal. Sipas ndarjes së grupeve të Njësive Administrative niveli i tarifimit për disa nga taksat dhe tarifat vendore të tyre për biznesin e vogël do të aplikohet në nivele të ndryshme përkatësisht:

- Grupi 1 – Njësia Administrative Peshkopi Zona A (niveli 100 %)
- Grupi 2 – 4 Njësi Administrative (Maqellarë, Tomin, Melan, Kastriot) Zona B (niveli 70%)

8.1 TARIFA E PASTRIMIT DHE LARGIMIT TË MBETURINAVE (viti 2024)

Përkufizimi: Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vëndas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Dibrë dhe njësive të saj administrative.

Niveli i tarifës së pastrimit: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

4	Subjektet e ndërtimit sipas investimit deri në : a) 5,000 .000 lekë b) 5,000 .000 - 25,000 .000 lekë c) 25,000 .000-100.000.000 lekë d) mbi 100.000.000 lekë	a)20,000	b)30,000 c)40,000 d)100,000	a)20,000	b)30,000 c)40,000 d)100,000	a)20,000	b)30,000 c)40,000 d) 100,000	
	Rikonstruksione të pjesshme	10,000	20,000	10,000	14,000	5,000	10,000	20,000
	Subjektet e ndërtimit për prodhim guri, inerte etj. Të ngjashme me to	20,000	50,000	20,000	50,000	20,000	50,000	30,000
4	Njësi shërbimi							
	Riparimi i artikujve elektro-shtëpiake radio, televizore, tj. Shërbime fotokopjimi, salloni bukurie, auto servise, kurse për makina (autoshkollë), agjensi doganore, agjensi këmbimi valutë, agjensi turizmi, pastrim kimik, marangoz, rrobaqepës, etj. Të ngjashme me to.	5,000	15,000	5,000	15,000	5,000	15,000	10,000
	Kompleks sportive, palestër, fitness, pishinë, qendra e institute kërkimore-shkencore, sallat koncerte-mbledhje e videoteka, Lojëra me kompjuter, Institucione jopublike të edukimit (shkollat, kopshte apo cerdhe), shërbimet në klinikat e specialiteteve të ndryshme mjekësore, shërbimet në laboratore diagnostikimi	5,000	15,000	5,000	15,000	5,000	15,000	

5	Profesione të lira							
	Avokat,Noter,Mjek,Mjeku laborant,stomatologu,farmacisti,ekonomisti kontabël i miratuar,mësuesit,veterinerët,agronomet,botue sit,inxhinierët,arkitekti, profesione të lira të cilat ushtrohen në njësi fikse apo në ambiente të ndryshme etj, të ngjashëm me to	8,000	15,000	8,000	10,500	8,000	7,500	10,000
6	Ambulantë							
	Subjektet që nuk kanë një vendodhje fikse,taxi,tregtia ambulante në tregje publike dhe private				8,000			
	Institucione shtetërore Buxhetore Shoqata,fondacione,ente të ndryshme shtetërore,organizata jo qeveritare, organizata jo fitimprurëse. Institucionet arsimore,kulturore,sportive private/shtetërore				50,000			
	Bankat				100,000			
7	Kompani Sigurimesh,Bastesh	15,000	30,000	15,000	30,000	15,000	30,000	20,000
	Kompani Telefonike							
	Fondacionet Kredidhënëse,Arsimore etj,	15,000	50,000	15,000	50,000	15,000	50,000	20,000
	Ujësjiellësi				50,000			
	OSHEE				250,000			
	Spitali				250,000			
	Posta Shqiptare,ALBtelecom sh.a				150,000			
	Karburante,njësi tregtimi lëndësh djegëse,hidrokarbure etj, Të ngjashme me to	15,000	30,000	15,000	30,000	15,000	30,000	15,000

	Lavazhe	10,000	30,000	10,000	30,000	5,000	30,000	20,000
	Drejtoria Projektimi	20,000	40,000	20,000	40,000	20,000	40,000	20,000
8	Shoqëri transporti							
	a)brenda qarkut	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000
	b)jashtë qarkut	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000
	Për çdo mjet transporti me Nipt Parësor apo sekondar sipas Q.K.B							
	a)Transport udhëtarësh deri në 8+1	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000
	b)Transport udhëtarësh mbi 8+1	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000
	c)Transport mallrash deri në 3.5 ton	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000
	d)Transport mallrash mbi 3.5 ton	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000
9	Miniera,ndërmarrje vip etj, Sipas fuqisë prodhuese:	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000
	Hidrocentrale,hece etj, Sipas fuqisë prodhuese:							
	a)0-2 mega	130,000	130,000	130,000	130,000	130,000	130,000	130,000
	b)mbi 2 mega	260,000	260,000	260,000	260,000	260,000	260,000	260,000

8.2 Për shërbimin e depozitimit të mbetjeve në fushën e mbetjeve Peshkopi

- Bizneset që do të transportojnë me mjetet e tyre mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i tyre do të përjashtohen nga tarifa vjetore e pastrimit. Mbetjet do të depozitohen pasi të paguhet tarifa prej 250 lekë/ton për mbetje të ngurta urbane, në zbatim të Ligjit nr. 10463 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", bazuar në fletëpeshores së sjellë nga biznesi, së bashku me dokumentacionin shoqërues që përcakton llojin e mbetjeve. Nëse lindin dyshime, Bashkisë Dibër i jepet e drejta që në çdo kohë të kontrollojë llojin dhe sasinë e mbetjeve. Në rast se mbetjet paraqiten pa dokumentacionin përkatës, ato do të tarifohen sipas çmimeve të depozitimit të mbetjeve të përcaktuara nga institucionet (me orë pune, sipas manualit të çmimeve të ndërtimit).
- Për institucionet që kërkojnë shërbim të veçantë në venddepozitim (si Agjencia Doganore Bllatë, AKU etj.), për shërbimin të veçantë të punës së tyre në lidhje me asgjësimet, shërbimi do të tarifohet duke marrë në konsideratë çmimet e manualit të ndërtimit të përcaktuara në VKM nr. 629, datë 15.07.2015.

9. PLANIFIKIMI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE 2025 – 2030

Bashkia Dibër gjatë 5 vjeçarit të zbatimit të planit lokal për menaxhimin e mbetjeve kërkon mbi të gjitha të konsolidojë shërbimin në zonat ku aktualisht e ofron këtë shërbim, duke rritur gradualisht cilësinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve për venddepozitim. Më tej ajo kërkon të fillojë të zbatojë skema për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve urbane, duke synuar mbylljen e ciklit të plotë të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Ky plan ka parashikuar hartimin e objektivave si më poshtë:

1. Konsolidimi i shërbimit me dy turne në qytet dhe mbulimi 100% i pjesës urbane të bashkisë gjatë periudhës 2025–2030.
2. Zgjerimi i shërbimit 70% në zonën rurale gjatë periudhës 2025–2030.
3. Rritja e shkallës së grumbullimit të diferencuar tek bizneset në masën 50% dhe pilotimi i sistemit të grumbullimit të diferencuar me dy kosha (të riciklueshme të thata dhe të tjera) për banorët në 6000 zone të qytetit përgjatë periudhës 2025–2030.
4. Ndertimi i një Landfilli / Stacioni i Transferimit sipas kriterëve ligjore si venddepozitim perfundimtar i perpunimit të tyre. Organizimi i infrastrukturës së grumbullimit të diferencuar të rrymave.
5. Ekonomia qarkulluese.
6. Nxjerrja e mbetjeve të riciklueshme (kartonë, plastikë, etj.) jashtë orarit të përcaktuar nga bashkia, si dhe hedhja e inerteve në hapësira publike pa leje dhe në kundërshtim me rregulloret mjedisore, përbëjnë shkelje të rregullave për menaxhimin e mbetjeve. Për këto shkelje parashikohen masa ndëshkuese, përfshirë gjobitjen.
7. Edukimi dhe Ndërgjegjësimi i Komunitetit, zhvillimi i fushatave të vazhdueshme për edukimin mjedisor në shkolla, media lokale dhe komunitet.
8. Digitalizimi i Shërbimit të Mbetjeve, përdorimi i GPS për monitorimin e automjeteve të mbetjeve dhe optimizimin e itinerareve.
9. Njësitë administrative do të kryejnë monitorim dhe raportim të rregullt mbi identifikimin e zonave me ngarkesë të lartë mbetjesh (hotspot), si dhe mbi performancën e shërbimit të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve në përputhje me standardet e përcaktuara.

Dua të theksojmë që për sa i përket rehabilitimit të vend-depozitimit ekzistues në Llasen jemi në pritje të përgjigjes për ofrimin e mbështetjes teknike dhe financiare nga **Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve** në varësi të Ministrisë së **Infrastrukturës dhe Energjisë** dhe donatore për krijimin e një landfilli ose pike stacionimi dhe një pike grumbullimi për mbeturina inerte.

9.1 Rryma e mbetjeve, objekti i planit

Sipas legjislacionit në fuqi, ky plan do të fokusohet në rrymën e mbetjeve bashkiake (urbane) për të cilën Bashkia Dibër është drejtpërdrejt apo pjesërisht përgjegjëse: Sipas përbërjes dhe mënyrës së menaxhim të mbetjeve, mbetjet bashkiake do të klasifikohen në:

- Mbetje urbane (mbetje shtëpiake, ushqime, bimë, të riciklueshme, të dekompozuar, etj.), dhe
- Mbetje të veçanta urbane (mbetje ndërtimet dhe prishjet, voluminoze, pajisje elektrike dhe mobiljesh, etj.) që prodhohen nga familjet apo njësitë tregtare;
- Mbetje të rrezikshme që prodhohen brenda territorit të bashkisë nga banorë të përhershëm apo të përkohshëm.

Sipas burimit të gjenerimit mbetjet urbane (bashkiake) klasifikohen në dy rryma:

- Mbetjet e gjeneruara nga familjet (MF)
- Mbetjet e gjeneruara nga bizneset dhe industritë (MB), ku përbërja e mbetjeve nuk ndryshon nga karakteristikat e mbetjeve urbane

Ndërkohë, rryma të tjera të mbetjeve klasifikohen si mbetje masive, mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (inerte), mbetje nga kopshtet që prodhohen në familje dhe që quhen ‘mbetje të veçanta’ për të cilat njësi vendore duhet t’i ofrojë e vetme ose në bashkëpunim alternativa të përshtatshme për grumbullimin dhe transportin e tyre, megjithëse largimi i tyre është përgjegjësi direkte e prodhuesit.

9.2 Zona e Administrimit të Mbetjeve (ZAM) dhe përfituesit e shërbimit të pastrimit

Në funksion të organizimit më të mirë të shërbimeve dhe eficiencës së sistemit që do të propozohet, zonat e mbetjeve ose zona brenda kufijve administrative të bashkisë do ndahet në nën-zona mbetjesh që kanë diferenca në lidhje me tipologjinë urbane, infrastrukturën rrugore apo llojin e konsumatorëve. Kjo është e rëndësishme që sistemet dhe metodat që do të identifikohen dhe analizohen në vijim të këtij plani të përshaten më mirë me qëllim e rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve. Kjo do të shërbejë për të planifikuar infrastrukturën e nevojshme për skemat e mbledhjes dhe transportit, si dhe shërbime të tjera të ngjashme apo organizimin e programeve për minimizimin e mbetjeve.

Për këtë qëllim, zona e mbetjeve ndahet në këto nënzona:

- **Zona 1 – Zona e gjelbër – bulevardi kryesor**

Zona 1.1 - Lagja Treg–dhe qese mbeturinash, 120 lt, 70x110 cm, të zeza

- **Zona 2– Sistemi me dy kosha për ndarjen e mbetjeve (organike dhe letër) në lagjen Nazmi Rushiti dhe Gjok Doci**

Shkollat – Sistem me 3 kosha

10. SHËRBIMET E MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Në këtë plan 5 vjeçar, Bashkia Dibër parashikon shërbime kryesore të menaxhimit të mbetjeve, të cilat konsistojnë në:

1. Konsolidimi i shërbimit dhe mbulimi 100% i pjesës urbane të baskisë me dy turne gjatë periudhës 2025–2030
2. Zgjerimi i shërbimit në 100% në zonën urbane dhe 70% në zonën rurale gjatë periudhës 2025–2030
3. Rritja e shkallës së grumbullimit të diferencuar tek bizneset në masën 50% dhe pilotimi i sistemit të grumbullimit të diferencuar me dy kosha (të riciklueshme të thata dhe të tjera) për banorët në 6000 zone të qytetit përgjatë periudhës 2025–2030.
4. Ndertimi i nje Landfilli / Stacioni i Transferimit sipas kriterëve ligjore si venddepozitim perfundimtar i perpunimit te tyre. Organizimi i infrastrukturës së grumbullimit të diferencuar të rrymave.
5. Ekonomia qarkulluese.
6. Nxjerrja e mbetjeve të riciklueshme (kartonë, plastikë, etj.) jashtë orarit të përcaktuar nga bashkia, si dhe hedhja e inerteve në hapësira publike pa leje dhe në kundërshtim me rregulloret mjedisore, përbëjnë shkelje të rregullave për menaxhimin e mbetjeve. Për këto shkelje parashikohen masa ndëshkuese, përfshirë gjobitjen.
7. Edukimi dhe Ndërgjegjësimi i Komunitetit, zhvillimi i fushatave të vazhdueshme për edukimin mjedisor në shkolla, media lokale dhe komunitet.
8. Digitalizimi i Shërbimit të Mbetjeve, përdorimi i GPS për monitorimin e automjeteve të mbetjeve dhe optimizimin e itinerareve.
9. Njësitë administrative do të kryejnë monitorim dhe raportim të rregullt mbi identifikimin e zonave me ngarkesë të lartë mbetjesh (hotspot), si dhe mbi performancën e shërbimit të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve në përputhje me standardet e përcaktuara.

Të nënta këto shërbime do të përfshihen në skenarët e propozuar nga bashkia për organizimin e shërbimit në territorin e saj gjatë viteve 2025-2030.


Zbatimi i skemave të ndryshme të menaxhimit në qytetin e Peshkopisë

Qyteti i Peshkopisë, si zona kryesore urbane dhe qendra e aktivitetit njerëzor dhe institucional, do të fokusohet në disa skema të ndryshme pilot, në mënyrë që të nisë zbatimin e dispozitave të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar për ndarjen e mbetjeve.

Përshkrimi se si do të funksionojë shërbimi në zonat e përzgjedhura.

Zona 1 – Zona e gjelbër – bulevardi kryesor

Si imazhi kryesor i qytetit të Peshkopisë, bulevardi, do të jetë zonë pilote e qytetit për një Dibër të pastër. Në bulevard do të funksionojë sistemi për ndarjen e mbetjeve, ku do të përfshihet sistem me tre kosha: për qelq, letër dhe metal.




Zona 1.1 - Lagja Treg–dhe qese mbeturinash, 120 lt, 70x110 cm, të zeza

Në lagjen Treg dote përdoren qese mbeturinash, plastike, 120 lt, 70x110 cm, e zezë, të cilat mbushen nga qytetarët dhe nxirren në një kohë të caktuar, bëjnë të mundur largimin e konteinerëve në zonën e tregut. Këto qese janë praktike dhe të qëndrueshme, duke u siguruar që mbeturinat të mbledhen në mënyrë të rregullt dhe të pastër. Përdorimi i këtyre qeseve ndihmon në përmirësimin e higjienës në zonat publike dhe rrit ndërgjegjësimin për menaxhimin e mbeturinave.




Zona 1.2– Sistemi me dy kosha për ndarjen e mbetjeve (organike dhe letër) në lagjen Nazmi Rushiti dhe Gjok Doci

Në këtë zonë (kudo ku të jetë e mundur) do të vendoset një sistem me dy kosha. Koshat do të kenë një ngjitës, i cili do t'u tregojë qytetarëve se ku duhet të hidhen mbetjet e thata ose ato të njoma. Pjesa e lagjes Nazmi Rushiti dhe Gjok Doci në qytetin e Peshkopisë është zona e trete në menaxhimin e mbetjeve. Kjo për shkak të popullsisë në zonë dhe bizneseve të shumta që kanë një sasi të madhe të mbetjeve të thata. Për arritjen e kësaj qasjeje, qytetarët dhe bizneset janë njoftuar për orarin se kur do të kalojë kamioni dhe se kur punëtorët do të hyjnë në këtë lagje për të marrë mbetjet, në mënyrë që të ndajnë mbetjet në burim. Duke e konsideruar këtë si përpjekjen e parë për këtë lloj menaxhimi, do të duhet pak kohë që të ndërtohet besimi dhe bashkëpunimi me qytetarët, prandaj stafi i Bashkisë do t'i kushtojë vëmendje të veçantë kësaj pjese të qytetit.



Shkollat – Sistem me 3 kosha

Në të gjithë shkollat që do të përfshihen në shërbimin e zgjeruar, pritet të vendoset sistemi për ndarjen e mbetjeve në burim. Një nismë e tillë do të fillojë ketu, dhe do të shtrihet edhe më tej, për të futur të gjitha parimet e menaxhimit të integruar të mbetjeve. Shkollat kryesore në qytetin e Peshkopisë do të jenë të parat që do të kenë sistemin me 3 kosha dhe mësuesit do të angazhohen në edukimin e fëmijëve dhe monitorimin e situatës çdo ditë, në mënyrë që kjo nismë të funksionojë. Duke marrë parasysh që shkollat kanë numrin më të madh të individëve në një zonë, sasia e mbetjeve të gjeneruara dhe të grumbulluara do të jetë domethënëse dhe kjo do të jetë një mesazh për pjesën tjetër të njësisë.



Popullsia që do marrin këtë shërbim është afër 71,612 veta. Bashkia do t'i grumbullojë t'i mbledhë mbetjet e riciklueshme në kosha specifike si dhe kontenierë 1.1 m³, në varësi të zonës do vendosen edhe koshat me të përshtatshëm. Ky shërbim mendohet të ofrohet 2 herë në javë. Mbetjet e riciklueshme do dergohen në vendepozitimin e qytetit të Peshkopisë, në zonën e unazës së re, Peshkopi.

11. PLANI I FSHIRJES SË QYTETIT PESHKOPI (2025–2030)

Shërbimi i fshirjes nuk bazohet në një sistem normimi apo standardizimi. Gjithashtu, Bashkia nuk ka një rregullore pastrimi të qytetit dhe puna kryhet në bazë të përvojës shumëvjeçare.

Për këtë arsye, lind nevoja e vendosjes së një sistemi përlllogaritje të nevojave dhe operacioneve të fshirjes/pastrimit. Në kushtet e mungesës së një standardi kombëtar në këtë përlllogaritje, janë marrë në konsideratë normat nga qytete të tjera, të cilat kanë një sistem të konsoliduar pastrimi siç është qyteti i Durrësit.

11.1 Standardizimi i procesit të fshirjes



Ushtrimi i mëposhtëm bazohet në përvojën e grumbulluar në njësitë vendore me më shumë përvojë në këtë shërbim. Aktualisht (2025), nuk ka një manual shërbimi me normar të përcaktuara qartë të punës dhe të materialeve, të cilat mund të përdoren për të analizuar saktë nevojën operacionale, logjistike dhe financiare për këtë shërbim. Për këtë arsye, në këtë plan, shërbimi është përlllogaritur në bazë të kriterëve të mirëpranuara deri më tani.

Shërbimi do të vijojë të kryhet vetëm në njësinë qytet (Peshkopi) dhe do të konsistojë në fshirjen dhe largimin e mbetjeve të grumbulluara, duke zgjeruar pak më shumë territorin që përfshihet aktualisht në procesin e fshirjes.

Kështu, normat ditore janë të përcaktuara në bazë të turneve, ku turni i parë ka një normë prej 13.400 m² për person dhe turni i dytë 20.000 m² për person.

Sipërfaqja totale në të cilën kryhet shërbimi i fshirjes, siç është përmendur edhe më lart, është 70.329 m², nga të cilat 4.411 m² janë *hapësira publike* dhe 65.918 m² *rrugë* (të asfaltuara dhe të paasfaltuara). Kjo shtrirje do të vijojë të mbetet e njëjtë, por cilësia e shërbimit do të përmirësohet edhe me përmirësimin e rrugëve, të bulevardit dhe të shesheve.

Shërbimi Aktual i Fshirjes (Peshkopi)



12. GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTI I MBETJEVE

Në parashikimin e shërbimeve të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve Bashkia duhet të marrë në konsideratë parimin për parandalimin e ndotjes. Cilësia dhe kostot e shërbimit të mbledhjes dhe largimit të mbetjeve urbane lidhen drejtpërdrejtë me mënyrën se si konsumatorët hedhin mbetjet, përdorin PGM, respektojnë oraret e përcaktuara dhe zbatojnë rregullat lokale për menaxhimin e mbetjeve. Në këtë aspekt, bashkia duhet të plotësojë kuadrin e saj rregullaror në sajë të:

- Rishikimit të rregullores vendore për menaxhimin e mbetjeve, ku do të rishikohen procedurat, protokollet e punës, parashikimet se çfarë do të ndodh në rast avarish apo aksidentesh në punë, të drejtat dhe detyrimet e të gjitha grupeve të interesit të përfshira në menaxhimin e mbetjeve si dhe gjobat përkatëse në rast të shkeljeve të evidentuara. Si parakusht, bashkia duhet të caktojë një grup pune për monitorimin dhe për të vënë në zbatim këto rregulla;
- Parandalimin e hedhjes së paligjshme dhe derdhjen e mbetjeve jashtë kontenierëve gjë që duhet të sjellë në vëmendje rëndësinë kryesore që kanë fushatat e ndërgjegjësimit dhe programet e edukimit;
- Marrëveshje me konsumatorët e mëdhenj, për të përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e secilës palë, ku rekomandohet vendosja e orareve në ditë dhe orë të caktuara për dorëzimin e mbetjeve nga konsumatori në pikat e caktuara nga bashkia, ose grumbullimi i tyre nga bashkia, në sajë të një kontrate të veçantë, në pikat e gjenerimit të tyre.

Ndërkohë elemente të tjerë që kanë të bëjnë me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, që bashkia duhet të marrë në konsideratë gjatë planifikimit të shërbimit në territorin e saj, janë si më poshtë:

- Orare pune efektive dhe të përshtatshme: Për të operuar sipas nevojave të pastërtisë dhe në mënyrë të efektshme dhe me kosto të ulët, bashkia duhet të hartojë një program efektiv dhe të përshtatshëm pune. Ky program duhet të marrë parasysh ndryshimet ditore, javore dhe mujore në lidhje me numrin e banorëve dhe veprimtarive tregtare.
- Numri i duhur i kontenierëve: Për të ofruar një shërbim të efektshëm dhe me kosto të ulët, bashkia duhet të sigurojë numrin e duhur të kontenierëve apo koshave dhe rregullsinë e mbledhjes së mbetjeve.
- Itenerar efektiv për mbledhjen e mbetjeve: Përcaktimi i saktë i itenerarit për makinat e mbetjeve do të ulë koston duke pakësuar forcat që shpenzohen për mbledhjen e mbetjeve. Rekomandohet verifikimi i përputhshmërisë me parimet e efektshmërisë së itenerarit të grumbullimit të mbetjeve si dhe të kohës efektive me metodën (MTM – Metodës të Matjes së Kohës).
- Rritja e rendimentit në punë: Bashkia apo kompanitë private duhet të gjejnë mekanizma për të përmirësuar punën duke rritur rendimentin. Masat që mund të ndërmerren për të rritur moralin, përfshijnë përmirësimin e kushteve të përgjithshme të punës, pajisja me uniforme, stimujt për punë të mirë, trajnimi dhe forcimi i punës në grup.
- Mirëmbajtja e përshtatshme e kontenierëve dhe makinave të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve: Mirëmbajtja dhe riparimi i specializuar i makinave dhe pajisjeve janë çështje të rëndësishme për shërbimin e mbledhjes së mbetjeve. Pavarësisht nëse shërbimi ofrohet nga bashkia apo kontraktohet një kompani private, bashkia duhet të përcaktojë ose parashikojë në kontratë mirëmbajtjen e duhur dhe standardet e riparimit që duhet të vihen në zbatim.


Referuar gjëndjes aktuale të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve si dhe eksperiencës, arritjeve dhe problematikës të identifikuar në kapitujt e mëparshëm të këtij plani, nënvizojmë se shërbimi i ofruar në qytetin e Dibërs është më mirë se në zonat rurale. Megjithatë Bashkia është e motivuar dhe e angazhuar të përmirësojë këtë situatë duke synuar si përmirësimin e nivelit aktual të ofrimit të shërbimit në lidhje me cilësinë, efikasitetin dhe efektshmërinë, por gjithashtu të krijojë një bazë të qëndrueshme mbi të cilën do të mbështeten iniciativat lokale dhe rajonale për minimizimin e mbetjeve. Për bashkinë është shumë e rëndësishme, jo vetëm konsolidimi i shërbimit dhe diversifikimi i tyre në NJA Dibër apo në qendrat urbane të njësive të tjera administrative, por edhe në rritjen e cilësisë në zonat rurale të njësive të tjera administrative.

Duke kaluar në një përjasje teknike, ekzistojnë mënyra të ndryshme për grumbullimin, ruajtjen dhe transportin e mbetjeve në funksion të kategorive të konsumatorëve dhe tipologjisë urbane të zonave të banuara. Sipas legjislacionit aktual dhe tipologjisë së zbatuar më së shumti për mbledhjen e mbetjeve, bashkia është përgjegjëse për të mbledhur vetëm “mbetjet urbane”, sipas përcaktimeve të dokumentave ligjorë dhe të këtij plani. Mbetje të tjera që ndryshojnë në përmbajtje (përbërje) nga mbetjet urbane nuk prahen nga sistemi i bashkiak për grumbullimin e mbetjeve.

Për disa mbetje të ashtuquajtura “të veçanta” që prodhohen nga banorët mund të organizohen metoda për grumbullimin e tyre në mënyrë të diferencuar nga sistemi publik (bazë) bashkiak. Ekzistojnë kufizime të tjera për përdorimin e sistemit bazë bashkiak të grumbullimit të mbetjeve që lidhet me madhësinë dhe sasinë e mbetjeve veçanërisht nga konsumatorët jo-banorë. Duke iu referuar përcaktimeve ligjore (Neni 12 i Ligjit Nr. 8094, datë 21.3.1996), konsumatorët jo-banorë që prodhojnë mbi $\frac{1}{4}$ e sasisë që mund të hidhet në një kontenier mbetjesh (zakonisht 1.1m³) nuk lejohen të përdorin sistemin publik të grumbullimit të mbetjeve. Autoritetet vendore apo personat përgjegjës për grumbullimin e mbetjeve duhet të ofrojnë mundësi dhe metoda të tjera për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve, në përmbushje të kërkesave dhe nevojave të konsumatorëve, shoqëruar me një sistem të ndryshëm tarifash.

Në lidhje me përcaktimin e infrastrukturës së nevojshme për zbatimin e skemës së përbashkët për grumbullimin e mbetjeve, duke marrë në konsideratë numrin e popullsisë sipas formulës të llogaritur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe qëllimit për mbulimin e të gjithë territorit të bashkisë me shërbim, u realizua analiza për llogaritjen e infrastrukturës së nevojshme: kontenierë dhe makina teknologjike. Si fillim u përcaktua kapaciteti i përshtatshëm i kontenierëve si dhe frekuenca e dëshirueshme e shërbimit. Kontenierët me volum 1.1m³, plastik për qytetin e Dibër dhe metalik për njësitë e tjera administrative, rekomandohen si më të përshtatshëm për grumbullimin e mbetjeve në këtë bashki. Ndërkohë bazuar në sasinë e mbetjeve të gjeneruara, frekuencës të ofrimit të shërbimit, dhe eksperiencës të ofrimit të shërbimit në Bashkinë Dibër, për territorin e saj Bashkia preferon mjete teknologjike 6 ton, dhe vetëm në rrugica të ngushta në qytet dhe në rrugët e ngushta të zonave rurale, përdorimin e mjeteve teknologjike 1.640 ton apo kamioncinave.

Në figurën më poshtë tregohet skematikisht skema e përgjithshme e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në territorin Bashkisë Dibër:



12.1 Menaxhimi i mbetjeve voluminoze dhe ndërtimore

Sipas kuadrit ligjor në fuqi për administrimin e mbetjeve (VKM nr.575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”) është përgjegjësia e prodhuesit (familje, biznes apo industri) që të largojë dhe transportojë mbetjet inerte (mbetjet nga ndërtimi dhe prishjet), ndërtimore apo voluminoze që mund të gjenerojë nga aktiviteti që kryen për në vendet e përcaktuara nga pushteti vendor për këtë qëllim. Ndonëse ekziston ky kuadër ligjor, i cili përcakton mjaft mirë detyrat për secilin aktor të përfshirë në këtë fushatë, asnjë nga bashkitë e vendit nuk ka përcaktuar një vend për depozitimin e mbetjeve inerte.

Në kuadrin ligjor theksohet se këto vende të përcaktuara për depozitimin e mbetjeve inerte/ndërtimore/voluminoze duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore të posaçme dhe duhet të pranojnë vetëm këto lloj mbetjesh, dhe jo përzjerje apo përpunime të këtyre mbetjeve me elemente të tjerë, pasi ato mund të jenë të rrezikshme.

Të gjitha venddepozitimet e mbetjeve inerte kanë të njëjtën mënyrë operimi si landfillet për mbetjet urbane, ku gjeneruesi i mbetjeve duhet të paguajë një tarifë kundrejt sasisë së mbetjeve inerte që transportohet, e cila mbulon koston e operimit të fushës, trajtimit të tyre dhe mbylljen përfundimtare të saj. Ndërkohë ndalohej ndërtimi i venddepozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte nga njësitë e qeverisjes vendore në zonat e mëposhtme:


- Zonat e mbrojtura, arkeologjike, turistike apo në çdo zonë që mbrohet me një akt normativ;
- Zonat në distancë 300 metra nga një pus furnizues me ujë dhe çdo burim tjetër ujor;
- Zonat në distancë 100 metra nga një përrua, argjinaturë lumore, liqen, lum ose kompleks ligatinor;
- Zonat në distancë 300 metra nga një zonë e mbrojtur në përputhje me pikën e parë.

Landfillet e mbetjeve inerte mund të jenë landfille vendore, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të prodhuara brenda territorit të një NJQV-je ose landfille rajonale, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të shumë NJQV-ve. Njësitë e qeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për përcaktimin e vendit, ku do të ndërtohet landfilli rajonal dhe të mënyrës së funksionimit të tij. Operatorët, të cilët merren me trajtimin e mbetjeve në landfille dhe venddepozitimet e përkohshme të mbetjeve inerte, janë të detyruar të raportojnë pranë NJQV-ve dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për të dhënat e mbetjeve që trajtojnë.

Në mënyrë të veçantë, ka një treg ripërdorimi për agregatet që rrjedhin nga mbetjet e ndërtimeve në rrugë, kanalizime dhe projekte të tjera ndërtimi. Nëse nuk ndahen që në burim apo nuk transportohen veçmas, ato mund të përmbajnë sasi të vogla të mbetjeve të rrezikshme, përzjerja e të cilave mund të paraqesë rrezik të veçantë për mjedisin dhe mund të pengojë riciklimin.

Shpesh herë mbetjet inerte përzihen me mbetjet urbane dhe më pas depozitohen në venddepozitimin në vendin e caktuar Llasen, me një distancë 1 km nga Bashkia Dibër i cili është parashikuar të përdoret vetëm për depozitimin e mbetjeve urbane. Nga ana tjetër gjeneruesit e mbetjeve inerte shpesh herë i shkarkojnë ato në vende ilegale, atje ku të munden. Bashkia duhet të përcaktojë një zonë të caktuar në territorin e saj, ku të gjithë gjeneruesit e mbetjeve inerte të mund të dërgojnë mbetjet e tyre në këtë pikë dhe jo t'i hedhin ato në PGM të mbetjeve urbane apo në depozitime ilegale.

Venddepozitimi ne unaze te re



13. SKENARËT E MUNDSIËM NE MENAXHIMIN E MBETJEVE

Skenari Bazë

1. Grumbullimi i mbetjeve të përziera në 100% të zonës urbane dhe 40% të zonës rurale.
2. Transporti me mjete teknologjike dhe mjete të hapura (jo të mbyllura).
3. Depozitimi në fusha ekzistuese, pa përpunim të mbetjeve.
4. Ekonomia qarkulluese në fazë embrionale, pa strukturë të qartë.
5. Identifikimi dhe eliminimi i grumbullimeve ilegale.

Skenari I

1. Grumbullimi i mbetjeve të përziera në 100% të zonës urbane me dy turne në qytet dhe 70% të zonës rurale.
2. Transporti me mjete të mbyllura dhe mjete të hapura me GPS për monitorim.
3. Zëvendësimi i plotë i koshave të mbeturinave.
4. Rehabilitimi i venddepozitimit aktual, që është jashtë kontrollit higjeno-sanitar, gjatë dyvjeçarit të parë të zbatimit të planit (2025–2027).
5. Fillimi i grumbullimit të diferencuar në zonat urbane me dy kosha (të riciklueshme dhe të tjera) pranë bizneseve.
6. Identifikimi sistematik i “hotspot”-eve dhe ndërhyrja me masa administrative.
7. Ekonomia qarkulluese.
8. Nxjerrja e mbetjeve të riciklueshme (kartonë, plastikë, etj.) jashtë orarit të përcaktuar nga bashkia, si dhe hedhja e inerteve në hapësira publike pa leje dhe në kundërshtim me rregulloret mjedisore, përbëjnë shkelje të rregullave për menaxhimin e mbetjeve. Për këto shkelje parashikohen masa ndëshkuese, përfshirë gjobitjen.
9. Raportimi i njësive administrative, ditor dhe javor, mbi situatën e mbetjeve në zonat e mbulimit dhe identifikimi e raportimi i hotspot-eve.

Skenari II

1. Grumbullimi i mbetjeve (zona urbane 100% dhe 70% zona rurale).
2. Grumbullimi i diferencuar me dy kosha në tre zona pilote të qytetit / grumbullim i diferencuar për bizneset.
3. Zëvendësimi i plotë i koshave të mbeturinave.
4. Ndërtimi i një landfilli / stacioni të transferimit sipas kriterëve ligjore, si venddepozitim përfundimtar i përpunimit të tyre. Organizimi i infrastrukturës së grumbullimit të diferencuar të rrymave.
5. Fillimi i grumbullimit të diferencuar në zonat urbane me dy kosha (të riciklueshme dhe të tjera) pranë bizneseve.
6. Identifikimi sistematik i “hotspot”-eve dhe ndërhyrja me masa administrative.
7. Ndërtimi i një landfilli për mbetjet inerte.
8. Ekonomia qarkulluese.
9. Nxjerrja e mbetjeve të riciklueshme (kartonë, plastikë, etj.) jashtë orarit të përcaktuar nga bashkia, si dhe hedhja e inerteve në hapësira publike pa leje dhe në kundërshtim me rregulloret mjedisore, përbëjnë shkelje të rregullave për menaxhimin e mbetjeve. Për këto shkelje parashikohen masa ndëshkuese, përfshirë gjobitjen.
10. Raportimi i njësive administrative, ditor dhe javor, mbi situatën e mbetjeve në zonat e mbulimit dhe identifikimi e raportimi i hotspot-eve.

13.1 Përshkrimi i zonave për ndarjen në burim Në kuadër të zbatimit të Skenarit III për menaxhimin e mbetjeve, ndarja në burim për subjektet ekonomike (bizneset) do të realizohet në zona të përzgjedhura të qytetit, ku aktiviteti tregtar dhe industrial është më i përqendruar. Kjo qasje synon të rrisë efikasitetin e grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme dhe të reduktojë volumin e mbetjeve të përziera që përfundojnë në landfill.

Skenari III

1. Grumbullimi i mbetjeve (zona urbane 100% dhe 90% zona rurale).
2. Grumbullimi i diferencuar me dy kosha në tre zona pilote të qytetit / grumbullim i diferencuar për bizneset.
3. Zëvendësimi i plotë i koshave të mbeturinave.
4. Transportimi i diferencuar i mbetjeve të riciklueshme dhe mbetjeve mix (në TS dhe qendra për rikuperimin e materialeve).
5. Ndërtimi i një landfili / stacioni të transferimit sipas kriterëve ligjore, si venddepozitim përfundimtar i përpunimit të tyre. Organizimi i infrastrukturës së grumbullimit të diferencuar të rrymave.
6. Transportimi i diferencuar i mbetjeve të riciklueshme dhe mbetjeve mix (në TS dhe qendra për rikuperimin e materialeve).
7. Depozitimi i të gjitha mbetjeve në impiante të përpunimit dhe asgjësimit përfundimtar.
8. Organizimi i infrastrukturës së grumbullimit të diferencuar të rrymave të tjera.
9. Ndërtimi i një landfili për mbetjet inerte.
10. Fushata ndërgjegjëse dhe edukimi i qytetarëve dhe bizneseve për ndarjen e mbetjeve, kanalet e komunikimit: media, shkolla, aktivitete publike.
11. Ekonomia qarkulluese.
12. Nxjerrja e mbetjeve të riciklueshme (kartonë, plastikë, etj.) jashtë orarit të përcaktuar nga bashkia, si dhe hedhja e inerteve në hapësira publike pa leje dhe në kundërshtim me rregulloret mjedisore, përbëjnë shkelje të rregullave për menaxhimin e mbetjeve. Për këto shkelje parashikohen masa ndëshkuese, përfshirë gjobitjen.
13. Raportimi i njësive administrative, ditor dhe javor, mbi situatën e mbetjeve në zonat e mbulimit dhe identifikimi e raportimi i hotspot-eve.

Skenari Bazë

Vendepozitim ne Peshkopi, depozitim në fusha ekzistuese, pa përpunim të mëtejshëm të mbetjeve.

	Skenari bazë	Operation & Mirëmbajtje				
Zona 1	NJA Peshkopi	O&M			9,336,000 Lekë	
Zona 2	NJA Maqellarë	O&M			4,097,760 Lekë	
Zona 3	NJA Tomin, NJA Kastriot, NJA Melan, NJA Muhurr, NJA Silove	O&M			4,184,000Lekë	
		O&M totale			17,617,760 Lekë	

	Nr. kontenerësh	Nr. Makina	Tonazhi	Turnet	Sasia vjetore e mbetjeve (ton/vit)
NJA Peshkopi	192	2	Makina 1: 2.90 ton Makina 2: 1.64 ton	2	6457.125
NJA Maqellarë	144	1	6 ton	1 turn, 4 herë në javë	1023.36
NJA Tomin, NJA Kastriot, NJA Melan, NJA Muhurr, NJA Silove,	30	1	3.14 ton	Shërbimi realizohet sipas planit të përcaktuar, me metodën 'derë më derë'	2042
Totali	366	4			9,522

Skenari I

Vendepozitimi ne Peshkopi, Rehabilitimi i venddepazitimit aktual që është jashtë kontrollit higjeno-sanitar, gjatë dyveçarit të parë të zbatimit të planit.

Skenari 1						
Zona 1	NJA Peshkopi	O&M				9,336,000 Lekë
Zona 2	NJA Maqellarë	O&M				4,097,760 Lekë
Zona 3 dhe Zona 4	NJA Tomin, NJA Kastriot, NJA Melan, NJA Muhurr, NJA Kala Dodes,NJA Sillovë	O&M				6,505,040 Lekë
		O&M totale				19,938,800 Lekë
Zona 1		Kosto investimi – pajisje të reja (100 kontenierë të rinj + 1 makinë e re për mbledhjen e mbetjeve 4 ton)				7,572,382 Lekë
Zona 2	NJA Peshkopi	Kosto investimi – pajisje të reja (100 kontenierë të rinj)				3,540,000Lekë
Zona 3	NJA Tomin, NJA Kastriot, NJA Melan, NJA Muhurr	Kosto investimi – pajisje të reja (30 kontenierë të rinj + 1 makinë e re për mbledhjen e mbetjeve e hapur 5 ton)				2,850,000 Lekë
Zona 4	NJA Kala Dodes,Sillovë	Kosto investimi – (1 vetëshkarkuese e hapur për mbledhjen e mbetjeve 5 ton)				1,800,000 Lekë
		Kostoja totale e investimit				15,762,382Lekë
	Bashkia Diber	Kosto totale				35,701,182 Lekë
		Nr. kontenierësh	Nr. Makina	Tonazhi	Turnet	Sasia vjetore e mbetjeve (ton/vit)
NJA Peshkopi		100	1	4 ton	2	6457.125
NJA Maqellarë		100			1 turn, 4 herë në javë	1023.36
NJA Tomin, NJA Kastriot, NJA Melan, NJA Muhurr,		30	1	5 ton	Shërbimi realizohet sipas planit të përcaktuar, me metodën 'derë më derë'	2042
NJA Sillovë, NJA Kala e Dodes		0	1	5 ton	Shërbimi realizohet sipas planit të përcaktuar, me metodën 'derë më derë'	1040
Totali		230	3			10,562

Skenari II

Ndërtimi i një landfilli / stacioni të transferimit në pjesë dhe ndërtimi i një landfilli për mbetjet inerte.

	Skenari 2					
Zona 1	NJA Peshkopi	O&M				9,336,000 Lekë
Zona 2	NJA Maqellarë	O&M				4,097,760 Lekë
Zona 3 dhe Zona 4	NJA Tomin, NJA Kastriot, NJA Melan, NJA Muhurr, NJA Kala Dodes, NJA Slllovë	O&M				6,505,040 Lekë
		O&M totale				19,938,800 Lekë
Zona 1	NJA Peshkopi					4,072,382 Lekë
Zona1.1	Bulevardi "Elez Isufi" dhe lagjia e Pazarit				Kosto investimi – 1 makinë e re për mbledhjen e mbetjeve 4 ton	100,000 Lekë
Zona1.2	Lagjia "Gjok Doci" dhe "Nazmi Rrushiti"				Qese mbeturinash, 120 lt, 70x110 cm, të zeza	7,000,382 Lekë
Zona 2	NJA Maqellarë				Kosto investimi – 200 kontenerë të rinj (organike dhe letër)	1,740,000 Lekë
Zona 3	NJA Tomin, NJA Kastriot, NJA Melan, NJA Muhurr				Kosto investimi – 50 kontenerë të rinj	2,850,000 Lekë
Zona 4	NJA Kala Dodes, Slllovë				Kosto investimi – (makinë e re për mbledhjen e mbetjeve)	1,800,000 Lekë
					Kostoja totale e investimit	17,562,764 Lekë
	Bashkia Diber				Kosto totale	37,501,564 Lekë
		Nr. Kontenierësh	Nr. Makina	Tonazhi	Turnet	Sasia vjetore e mbetjeve (ton/vit)
NJA Peshkopi		200	1	4 ton	2	6457.125
NJA Maqellarë		50			1 turn, 4 herë në javë	1023.36
NJA Tomin, NJA Kastriot, NJA Melan, NJA Muhurr, NJA Slllove, NJA Kala e Dodes		30	2	Makina 1: 5 ton Makina 2: 5 ton	Shërbimi realizohet sipas planit të përcaktuar, me metodën 'derë më derë'	3082
Totali		280	3			10,562

Skenari III

Ndërtimi i një landfili / stacioni të transferimit në pjesë dhe ndërtimi i një landfili për mbetje inerte.

Skenari 3						
Zona 1	NJA Peshkopi	O&M				9,336,000 Lekë
Zona 2	NJA Maqellarë	O&M				4,097,760 Lekë
Zona 3 dhe Zona 4	NJA Tomin, NJA Kastriot, NJA Melan, NJA Muhurr, NJA Kala Dodes, NJA Sillovë dhe NJA Arras	O&M				8,505,040 Lekë
		O&M totale				21,938,800 Lekë
Zona 1	NJA Peshkopi	Kosto investimi – pajisje të reja (1 makinë e re për mbledhjen e mbetjeve)				7,572,382 Lekë
Zona1.1	Bulevardi "Elez Isufi" dhe lagjia e Pazarit	Qese mbeturinash, 120 lt, 70x110 cm, të zeza				200,000 Lekë
Zona1,2	Lagjia "Gjok Doci" dhe "Nazmi Rrushiti"	Kosto investimi – 200 kontenerë të rinj (organike, letër, qelqe dhe plastike)				7,000,000 Lekë
Zona 2	NJA Maqellarë	Kosto investimi – pajisje të reja 100 kontenerë të rinj (organike dhe letër)				3,540,000 Lekë
Zona 3	NJA Tomin, NJA Kastriot, NJA Melan, NJA Muhurr	Kosto investimi – pajisje të reja (30 kontenerë të rinj + 1 makinë vetëshkarkuese e hapur për mbledhjen e mbetjeve)				2,850,000 Lekë
Zona 4	NJA Kala Dodes, Sillovë dhe NJA Arras	Kosto investimi – (2 makina vetëshkarkuese të hapur për mbledhjen e mbetjeve)				3,600,000 Lekë
		Kostoja totale e investimit				24,762,382 Lekë
	Bashkia Diber	Kosto totale				46,701,182 Lekë

	Nr. kontenerësh	Nr. Makina	Tonazhi	Turnet	Sasia vjetore e mbetjeve (ton/vit)
NJA Peshkopi	200	1	4 ton	2	6457.125
NJA Maqellarë	100			1 turn, 4 herë në javë	1023.36
NJA Tomin, NJA Kastriot, NJA Melan, NJA Muhurr.	30	1	5 ton	Shërbimi realizohet sipas planit të përcaktuar, me metodën 'derë më derë'	3082
NJA Sillove, NJA Kala e Dodes dhe NJA Arras.	20	2	Makina 1: 5 ton Makina 2: 5 ton	Shërbimi realizohet sipas planit të përcaktuar, me metodën 'derë më derë'	624
Totali	350	4			11,186

14. MENAXHIMI I RRYMAVE TË TJERA TË MBETJEVE

14.1 Mbetjet elektrike dhe elektronike (MEE)

Qeveria Shqiptare ka aprovuar një VKM Nr. 957, datë 19.12.2012 “Për mbetjet që vijnë nga pajisjet elektrike dhe elektronike”, duke përcaktuar disa rregulla në lidhje me menaxhimin e këtyre mbetjeve”.

Në kreun IX-të i këtij Vendimi, paragrafi 5 përcakton se qeverisjet vendore duhet të llogarisin peshën totale të hyrjeve dhe të daljeve në territorin e tyre gjatë vitit kalendarik të mëparshëm dhe përqindjet respektive, siç përcaktohet në këtë vendim dhe duhet t’i rregjistrojnë këto të dhëna në rregjistrat e tyre të krijuar për këtë qëllim. Në kreun IX-të të këtij Vendimi, paragrafi 5 përcakton: Prodhuesit, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, duhet të marrin masat e nevojshme që konsumatorët të jenë pjesë e grumbullimit të diferencuar të MEE dhe të inkurajohen për të ndihmuar në procesin e ripërdorimit, të trajtimit dhe të rikuperimit.

Në këtë kontekst, Bashkia do të fokusohet në dy drejtime:

- Pastrimi i lumenjve dhe i zonave ku për vite me rradhë janë depozituar mbetjet elektrike dhe elektronike;
- Ndërtimi i qendrave për grumbullim të diferencuar të MEE të gjeneruar nga familjet dhe ndalimi i depozitimit të tyre në venddepozitime apo zona të tjera. Në të njëjtën kohë, Bashkia do t’u kërkojë pronarëve të MEE të respektojnë rregulloret vendore dhe VKM-në e lartpërmendur për të grumbulluar këto mbetje dhe për të monitoruar zbatimin e rregullave.

Sasia e mbetjeve të gjeneruara nuk mund të matet. Për këtë arsye, e vetmja masë që mund të merret është grumbullimi i tyre. Bashkëpunimi me institucionet e tjera, si për shembull Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe i Pyjeve (ISHMP), është kyç për kontrollin e këtij procesi.

14.2 Mbetjet nga vajrat e përdorur

Është shumë e rëndësishme të kryhet grumbullimi i këtyre mbetjeve, në mënyrë që të shmanget ndotja mjedisore, dhe, në të njëjtën kohë, për të përfituar nga riciklimi dhe përdorimi i këtyre substancave. Për këtë arsye, industria, konsumatorët dhe garazhet e automjeteve duhet të përfshihen në nismën e grumbullimit, duke minimizuar derdhjen e vajrave të përdorur dhe duke i dërguar ato tek grumbulluesit e autorizuar. Duke krijuar skemat publike – private për grumbullim, asgjësim dhe riciklim të këtyre mbetjeve, shkarkimi i pakontrolluar i tyre duhet të shoqërohet nga një numër i madh masash administrative.

- 14.2.1 Sasia e mbetjeve të gjeneruara nuk mund të matet. Për këtë arsye, e vetmja masë që mund të merret është grumbullimi i tyre. Bashkëpunimi me institucionet e tjera, si për shembull Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe i Pyjeve (ISHMP), është kyç për kontrollin e këtij procesi.

14.2.2 Mbetjet nga gomat e përdorura

Inspektimi i aktiviteteteve të paligjshme të grumbullimit privat dhe i tregtimit të gomave të përdorura, regjistrimit, mbledhjes të të dhënave në lidhje me sasinë e mbetjeve, si dhe parandalimi i djegies së pakontrolluar, mbeten detyrat parësore gjatë kësaj periudhe planifikimi.

15. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

15.1 Rregullorja vendore

Bashkia Dibër duhet të rishikojë miratojë rregulloren lokale për administrimin e shërbimit të mbetjeve, ku të përcaktohet qartë rolin dhe përgjegjësia e prodhuesve dhe operatorëve të mbetjeve, me qëllim administrimin e suksesshëm të tyre brenda territorit të saj administrativ. Kjo rregullore duhet të përcaktojë rregullat dhe procedurat për administrimin vendor të mbetjeve, procedurat për trajtimin e ankesave të qytetarëve si dhe gamën e sanksioneve për mosrespektim të rregullave.

Më konkretisht kjo rregullore duhet të përfshijë:

1. Standardet lokale të punës dhe cilësisë, metodologjitë dhe teknologjitë, rregullat e sigurisë dhe të shëndetit për shërbimet e pastrimit dhe të administrimit të mbetjeve;
2. Rregullat dhe detyrimet e prodhuesve të mbetjeve;
3. Sanksione në raste të dëmtimit të kontenierëve, të ndryshimit të funksionit apo vendodhjes së PGM apo kontenierëve;
4. Marrjen e masave parandaluese për mosdjegien e mbetjeve në kazanë, për moshedhjen e mbetjeve në rrymat ujore dhe kanalizimet, apo në vende të tjera nga ato të miratuara nga bashkia;
5. Marrjen e masave parandaluese për moshedhjen e mbetjeve voluminoze dhe atyre të rrezikshme, mosdepozitimin e kafshëve të ngordhura dhe mbetjeve të rrezikshme në PGM të mbetjeve urbane;
6. Shmangien e parkimit të automjeteve përballë apo pranë pikave të caktuara të grumbullimit të mbetjeve;
7. Marrjen e masave për pastrimin nga ana e pronarëve të hapësirave rreth dyqaneve dhe pikave ambulatorie të shitjes;
8. Marrjen e masave për sigurimin e një pastërtie të pranueshme duke dezinfektuar kontenierët dhe koshat rrugorë të depozitimit të mbetjeve;
9. Mbajtja e uniformave gjatë proceseve të punës nga punonjësit e pastrimit;
10. Përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të administruesve të mbetjeve (operatorët e mbetjeve, industria e mbetjeve):
 - Veprimet të kryhen vetëm nga kontraktorë të licencuar;
 - Procedurat administrative për dhënien dhe heqjen e licencave;
 - Pagesa e tarifave dhe taksave të vendosura nga autoriteti vendor;
 - Përdorimi i makinerive dhe kontenierëve të përshtatshëm;
 - Përdorim i vendeve të licensuara të depozitimit;
 - Regjistrimi i konsumatorëve që përfitojnë shërbime pastrimi;
 - Mbajtja e të dhënave historike për mbetjet;
 - Parandalimi i problemeve për shëndetin publik.

15.2 Zbatimi dhe sanksionet

Rregullorja vendore e administrimit të mbetjeve shoqërohet me një sërë gjobash dhe sanksionet që duhet të caktohen dhe miratohen nga Këshilli Bashkiak. Niveli i gjobave dhe sanksioneve duhet të bazohen në shërbimin e ofruar dhe në parimin “ndotësi paguan”, ku shkelësi duhet të ndëshkohet me qëllim që të merren parasysh kostot e pastrimit apo mbledhjes së mbetjeve, kostot mjedisore dhe për më tepër të krijohet një sistem i drejtë për dekurajimin dhe parandalimin e ndotësve. Gjambat lokale duhet të vendosen nga inspektorët bashkiakë që janë nën juridiksionin e bashkisë. Përgjegjësia kryesore e këtyre inspektorëve është të vendosin sanksione për personat fizikë apo juridikë që shkelin kushtet ligjore në lidhje me mbledhjen, largimin dhe transportin e mbetjeve.

16. NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK

Për të siguruar mirëfunksionimin e sistemit të menaxhim të mbetjeve, rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve si dhe sigurimin e pastërtisë në nivele të kërkuara në territorin e bashkisë, është shumë i domosdoshëm përfshirja dhe ndërgjegjësimi i komunitetit. Komuniteti jo vetëm duhet të kuptojë funksionimin e sistemit, por duhet ta mbështesë atë. Suksesi i çdo skeme menaxhimi mbetjesh bazohet plotësisht nga mbështetja e përdoruesve. Konsumatorët si familjet, bizneset apo institucionet, në sajë të një fushatë të fortë ndërgjegjësimi mund të ndikojnë në përmirësimin e sistemit të grumbullimit, duke zbatuar kërkesat e hedhjes dhe ndarjes së mbetjeve dhe duke penguar materialet e padëshirueshme (psh. mbetjet e rrezikshme), të hyjnë në rrymën e mbetjeve të grumbulluara. Ndërgjegjësimi publik ndaj çështjeve të mbetjeve dhe nivelit të pastërtisë, konsiderohet si një prioritet dhe objektiv primar krahas objektivave të tjerë që lidhen me infrastrukturën apo me depozitimin e sigurtë të mbetjeve. Ka disa mënyrë për të rritur ndërgjegjësimin publik për çështjet e mbetjeve dhe për të dhënë informacion se si mund të trajtohen ato, me një kosto relativisht të ulët, por mjaft efektive për arritjen e objektivit. Hartimi i një plani ndërgjegjësimi do të mundësojë: i) ofrimin e një informacioni të përgjithshëm dhe të veçantë për publikun në lidhje me nismat vendore të mbledhjes, riciklimit të mbetjeve, pastërtisë së territorit dhe kostos së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve; ii) ndërgjegjësimin e publikut për detyrimet ligjore, rregullat dhe detyrimet vendore; iii) nxitjen e qëndrimit miqësor ndaj mjedisit.

Metoda për komunikimin dhe informimin: Metodën më të përdorura të komunikimit të informacionit janë broshurat, artikujt në gazeta, njoftimet, dhe reklamat në TV dhe radio lokale, dhe fletëpalosje që shpërndahen në shkollë. Një zhvillim të lartë sot në vend ka edhe teknologjia e informacionit si edhe aksesin në internet. Kjo teknologji si edhe tërheqja pas rrjeteve sociale të komunitetit (kryesisht atij në moshë të re) mund të jetë një mundësi e mirë për komunikimin dhe informimin e publikut për shkak edhe të kostos së ulët si edhe shpejtësisë që ofron. Gjithashtu mund të shfrytëzohen dhe evente të karaktereve të ndryshme (festa, tubime, koncerte), ku ka grumbullime të mëdha njerëzish dhe ku informimi dhe komunikimi me publikun bëhet më i lehtë.

Në programet e riciklimit apo minimizimit të mbetjeve metoda më e mirë është ajo “derë më derë”. Kjo metodë fton konsumatorët në nismat e riciklimit dhe kompostimit, për të përmirësuar qëndrimin e tyre ndaj ndarjes së mbetjeve në burim, për të zbatuar rregullat dhe respektuar oraret. Banorëve dhe bizneseve iu shpërndahen fletë informative për llojet e mbetjeve që mund të riciklohen, kompostohen dhe mënyrën se si ato duhet të veprojnë për t’u bërë pjesë e procesit.

Përdorimi i makinave teknologjike që shërbejnë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve apo kontenerët për informim: Tek të gjithë makinat dhe nëse është e mundur tek kontenerët e mbetjeve duhet të shkruhet qartë dhe lehtësisht e lexueshme një slogane domethënëse për të mbajtur pastër zonën, numrin e telefonit të ofruesit të shërbimit si dhe numrin e telefonit falas që caktohet nga autoritetet vendore, sipas një formati të miratuar paraprakisht.

Marrja e opinioneve të qytetarëve: Një tjetër çështje e rëndësishme është krijimi i mekanizmave për marrjen e mendimeve dhe reagimit të qytetarëve: si mund të ftohet publiku t'i japë bashkisë mendime apo opinione ose komente për shërbimin e mbetjeve. Dy metodat kryesore për të marrë mendimin e publikut janë:

- Mundësia e publikut për t'u ankuar: Bashkia apo operatori i shërbimit duhet të ketë zyrën e kontaktit/informacioni për të marrë ankesat. Numri i ankesave dhe zgjidhja e tyre është një nga parametrat e matjes së performancës së institucionit lidhur me menaxhimin e mbetjeve.
- Vlerësimi i kërkesës dhe sondazhi/studimi i “vullnetit për të paguar”: Për të vlerësuar kërkesën, vullnetin dhe mundësinë për të paguar, lind nevoja për të komunikuar me përfituesit e mundshëm të shërbimit lidhur me alternativat e shërbimit, kostot, buxhetin dhe tarifat. Për secilën zonë të komunitetit apo zonë për t'u përfshirë në sondazh, kampionet që duhet të realizohen duhet të variojnë midis 100 dhe 200 të intervistuar. Kjo praktikë duhet të kryhet periodikisht nga bashkia, ose sa herë ajo e shikon të arsyeshme për të marrë opinionin e publikut në lidhje me vlerësimin e performancës të shërbimit.

16.1 Fushata e informimit në Bashkinë Dibër gjatë hartimit të planit

Bashkia duhet të promovojë në komunitet apo në zonat pilot, ide dhe mënyra të reja për manaxhimin e mbetjeve, si prezantimi i skemave të reja për grumbullimin e mbetjeve (në burim), ndarjen e mbetjeve, ripërdorimi i mbetjeve, metodat alternative të dorëzimit të mbetjeve, etj., duke ndërmarrë fushata ndërgjegjësimi për publikun e gjerë, të fokusuara për disa konsumatorë apo në një zonë pilot.

Synimi për këtë fazë është t'i informojë komunitetin se është marrë një vendim për aplikimin e një skeme të re; apo se ekziston një mënyrë tjetër më e preferueshme për manaxhimin e mbetjeve në krahasim me mënyrën tradicionale; dhe se ekzistojnë arsye të mira për të ndërmarrë një ndryshim në praktikën aktuale të menaxhimit të mbetjeve. Shpërndarja e këtij informacioni në publik duhet të vijë jo vetëm si një vendim i marrë në nivel bashkie, por edhe në formën e një kërkeje (me anë të një pyetësi, i cili do të vlerësojë nevojat e komunitetit dhe mendimi që ka komuniteti për aplikimin e skemave të reja të menaxhimit të mbetjeve).

Nisur nga ky fakt, bashkia mund të fillojë fushatën e ndërgjegjësimit me anë të një pyetësi, i cili mund të përsëritet periodikisht (1-2 herë në vit), për të vlerësuar si fillim opinionin e tyre në lidhje me gjendjen ekzistuese të menaxhimit të mbetjeve dhe prezantimit të metodave

të reja të menaxhim të mbetjeve, si ndarja në burim, riciklimi, kompostimi i mbetjeve. Në këtë pyetësor do të parashikohet edhe një pjesë në lidhje me opinionin/sjelljen e banorëve kundrejt tarifës së mbetjeve, a janë ata të informuar në lidhje me shërbimet të cilat ata paguajnë, mendimi i tyre në lidhje me propozimin e tarifave të reja për mbetjet etj.

Metodat më të preferuara të ndërgjegjësimit publik, të cilat mund të përdoren nga bashkia si fazë fillestare e ndërgjegjësimit të komunitetit për menaxhimin e mbetjeve është metoda derë më derë duke përfshirë vullnetarë apo studentë të interesuar të bëhen pjesë e fushatave aktive.

Një një fazë të dytë, komuniteti që tashmë është informuar dhe ndërgjegjësuar për çështjet e menaxhim të mbetjeve, si dhe për idetë apo programet e reja, do të kërkojë informacione të tjera shtesë, ose do të jetë në pritje për të kërkuar informacione shtesë, përderisa bashkia do të vendosë që të zbatojë këto skema të menaxhim të mbetjeve në territorin që ajo administron.

Qëllimi është që t'i bëjnë ata më shumë me dije psh. për praktikatat e kompostimit dhe riciklimit të mbetjeve ose për praktikatat e ndarjes së mbetjeve. Pas përcaktimit të zonave ku do të zbatohen skemat e ndarjes në burim (riciklim apo kompostim), bashkia duhet të fillojë të hartojë një program të detajuar, i cili duhet të ketë si qëllim jo vetëm informimin e komunitetit në lidhje me iniciativat e reja që janë ndërmarrë për menaxhimin e mbetjeve, por edhe konkretisht ku do të konsistojnë, infrastruktura e nevojshme, cili do të jetë roli i tyre në këto iniciativa, përfitimet konkrete që ata do të kenë, niveli i tarifave dhe metodat nxitëse financiare etj.

Kjo fazë e rritjes së interesit do të propozojë konkretisht hapat që do të ndjekë bashkia për të realizuar këtë fushatë ndërgjegjësimi, ku do të parashikohet të organizohen takime, seminare, vizita në terren, në impiantet e mbetjeve apo të riciklimit, etj., me pjesëmarrjen e individëve dhe grupeve të interesit duke përfshirë profesionistë dhe manaxherë të mbetjeve.

Vlerësimi dhe përmirësimi, në këtë fazë, drejtuesit e programeve të bashkisë duhet të jenë në gjendje të vlerësojnë programin dhe rezultatet e tij çdo 3 muaj, për të parë nëse programi është realizuar sipas parashikimeve, nëse ka rezultuar i suksesshëm, i përshtatshëm dhe financiarisht i përballueshëm për të përmbushur mjaftueshmërisht pritshmëritë dhe objektivat. Falë vlerësimit mund të përmirësohen aktivitetet, grafikët ose rrugët e operimit, të merren vendime nëse do të vazhdohet me programin, apo të merren vendime për përmirësimin dhe mbështetjen e tij etj. Nga ana tjetër, autoritetet vendore synojnë të përfshijnë njerëzit më pranë programit, të rrisin pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre.

Ky vlerësim mund të zhvillohet në fund të çdo fushate aktive (1 herë në muaj ose 1 herë në 3 muaj), ku njësia vendore përcakton disa forma të kontrollit si më poshtë:

- Vlerësim vizual në zonat, të cilat kanë filluar të zbatojnë skemat e reja të menaxhim të mbetjeve;
- Vlerësim sasior, në lidhje me sasinë e mbetjeve të cilat janë reduktuar nga rryma e përgjithshme e mbetjeve (pra kanë shkuar për riciklim apo kompostim);
- Vlerësim cilësor i zonave në të cilat janë vendosur infrastruktura të posaçme për trajtimin e mbetjeve, si kosha për riciklim apo për kompostimin e mbetjeve, nëse ato janë funksionale apo jo dhe nëse janë të mirëmbajtura apo jo;
- Vlerësim i opinionit të qytetarëve, kryesisht të atyre të cilët kanë filluar zbatimin e skemave të reja të menaxhim të mbetjeve me anë të një pyetësori të shkurtër, i cili duhet të nxjerrë në pah:

- ✦ A është e përshatshme skema për qytetarët;
- ✦ A janë ata të ndërgjegjësuar dhe informuar mjaftueshëm për operimin e suksesshëm të skemës;
- ✦ Sistemi i aplikuar i tarifave a justifikon mjaftueshëm skemën e re të menaxhim të mbetjeve etj.

Gjatë kësaj faze, si bashkia ashtu edhe konsumatorët do të kërkojnë prova të qëndrueshmërisë nga partneriteti i tyre i deritanishëm, me qëllim që palët të sigurohen se kontributi i gjithësecilit ka vlerë dhe se pala tjetër tregon përkushtimin e duhur. Në këtë fazë rekomandohen intervistat, takimet publike dhe seminarët për të treguar rezultatet dhe për të prezantuar hapat për të ardhmen.

Informimi për Sistemin e ri të tarifave: Bashkia me fillimin e aplikimit të skemave të reja do të fillojnë të aplikojnë edhe një sistem të ri të tarifave të mbetjeve, për një shërbim i cili do të ofrohet në një territor më të madh, ku në disa raste nuk ekzistonte më parë. Si fillim bashkia duhet të përcaktojë tarifën e mbetjeve dhe procesi i vendosjes së tarifës së mbetjeve duhet të kalojë në 9 hapa kryesorë, të cilat duhet të jenë pjesë e fushatës ndërgjegjëse për tarifën e mbetjeve:

1. Njohja me konsumatorët – bashkia duhet të identifikojë kategoritë dhe numrin e konsumatorëve që gjenerojnë mbetje në territorin e saj. Ky informacion duhet të paraqitet në broshurat informuese.
2. Sasia e mbetjeve që gjenerohen në bashki – Pasi janë përcaktuar kategoritë dhe numri i konsumatorëve, bashkia duhet të përcaktojë edhe sasinë e mbetjeve që gjenerohen në territorin e saj (sipas kategorive) dhe normat e gjenerimit të mbetjeve për kategoritë e konsumatorëve. Ky informacion që duhet të paraqitet në broshurat informuese do t'i japë mundësi konsumatorëve që të kuptojnë realisht sasinë e mbetjeve që gjenerohen në njësinë e tyre dhe sa e rëndësishme është pagesa e tarifës për të siguruar menaxhimin e tyre.
3. Vlerësimi i opsioneve teknike – Skema e re do të parashikojë edhe aspekte të reja teknike për mënyrën e ofrimit të shërbimit. Ky informacion, në lidhje me aspektet e reja teknike të shërbimit (nr. i kontenierëve, lloji i tyre për mbetjet miks apo të diferencuara, numri i makina për transport, stabilimentet për depozitimin e mbetjeve etj) duhet t'i vihet në dispozicion komunitetit, që ai të kuptojë realisht teknologjinë e ofrimit të shërbimit të ri.
4. Vendosja e marrëdhënies institucionale – Komuniteti duhet të njihet me ndarjen e përgjegjësisë dhe detyrave në skemën e re të ofrimit të shërbimit të mbetjeve. Cila do të jetë përgjegjësia dhe roli i secilit territor administrativ në skemën e re të menaxhimit të mbetjeve? Në këtë mënyrë ai do të kuptojë edhe dinamikën përkatëse në territorin ku ai ndodhet.
5. Njohja me koston e ofrimit të shërbimit – Për të vendosur tarifa sa më afër realitetit duhet të përcaktojmë koston e plotë të shërbimit të menaxhim të mbetjeve sipas shërbimeve që do të ofrohen: i) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve; ii) fshirjen dhe larjen e rrugëve; iii) trajtimin e ndërmjetëm të mbetjeve; iv) trajtimin final të mbetjeve; v) kostot operative; vi) kostot kapitale; vii) kostot indirekte etj. Në këtë mënyrë komuniteti e ka më të qartë koston e shërbimeve që ai do të marrë.

6. Identifikimi i burimit të të ardhurave – Komuniteti duhet të njihet edhe me burimet financiare të cilat do të sigurojnë ofrimin e shërbimit sipas standardeve.
7. Përzgjedhja e niveleve të duhura për tarifën dhe llogaritja e tyre – Pasi bashkia ka përcaktuar numrin dhe kategoritë e konsumatorëve, kostot e shërbimit dhe burimet e të ardhura, ajo ka mundësinë që të përcaktojë edhe nivelet e duhura të tarifave për kategoritë e ndryshme të konsumatorëve. Ky informacion është mëse i rëndësishëm për t'u ndarë me konsumatorët, ku ata njihen specifikisht se për cilat shërbime, me një kosto të caktuar, ata do të paguajnë.
8. Vendimmarrja strategjike – Në sajë të karakteristikave të njësive vendore merren disa vendime strategjike për vendosjen e nivelit të tarifave për kategoritë e konsumatorëve, ku përcaktohet sa përqind e koston pritët që të mbulohet nga mbledhja e tarifave.

Komunikimi i sistemit të ri të tarifave – bashkia mund të përcaktojë mënyrën më të mirë për informimin e publikut në lidhje me 8 hapat më lart, të cilat mund të realizohen me anë të takimeve periodike, standave në hyrje të bashkisë apo edhe me broshura informuese, ku japin rezultatet e 8 hapave më lart.

Nisur nga ky fakt, bashkia do të duhet të fillojë një fushatë ndërgjegjësimi për sistemin e ri të tarifave për mbetjet, e cila do të prekë qytetarët në dy nivele: i) ata që e paguanin më parë tashmë tani do të kenë një sistem të ri; ii) ata të cilët nuk kanë patur shërbim do t'u duhet së pari të njihen dhe të kuptojnë se si funksionon sistemi, ku ata do të bëhen pjesë dhe më pas të fillojnë të paguajnë.

Në fushatën ndërgjegjëse dhe informuese për sistemin e tarifave, e cila do të jetë pjesë e fushatës për promovimin e skemës së re ndërvendore, bashkia duhet të marrë në konsideratë këto parime:

- Alokimin efiçient të burimeve që ka në dispozicion bashkia;
- Ofrimi në mënyrë sa më efiçiente të shërbimit - krijimi i incentivave për të ofruar shërbimin me kosto sa më të ulët;
- Përdorimi efiçient i burimeve natyrore - përmbushja e objektivave mjedisore, si promovimi i skemave të riciklimit dhe kompostimit;
- Mbulimi i koston – tarifën e vendosura duhet të reflektojë të gjitha shërbimet që kryhen për shërbimin e menaxhim të mbetjeve;
- Qëndrueshmëria financiare – tarifën e vendosura duhet të reflektojë një qëndrueshmëri të sistemit të menaxhim të mbetjeve;
- Barazi horizontale mes përdoruesve, të cilët duhet të paguajnë të njëjtën shumë për të njëjtin nivel shërbimi të ofruar;
- Zbatimi i parimit “Ndotësi Pague”;;
- Parimi i “Proporcionalitetit” – sasia e tarifës duhet të reflektojë sasinë e shërbimit të ofruar;
- Parimi i “Transparencës” – vendosja e tarifës duhet të jetë e qartë dhe nëse ka incentiva ato duhet të qartësohen për komunitetin

17. RISHIKIMI I PLANIT

Ndjekja e zbatimit të planit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm me vlerësime periodike (çdo 5 vjet) ose më shpesh nëse është e nevojshme për vlerësimin dhe rishikimin e objektivave dhe masave. Monitorimi dhe vlerësimi mund të funksionojë si një bazë për rishikimin e planit.

Çështje të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë kur të analizohet ky plan janë sigurisht vlerësimi nëse objektivat janë përmbushur, nëse masat e parashikuara kanë qenë efektive apo jo. Një plan duhet të rishikohet gjithashtu, kur politika kombëtare e mbetjeve rekomandon apo detyron ndryshime thelbësore në mënyrën e menaxhim të mbetjeve apo vendos objektiva të ndryshëm në funksion të obligimeve ndërkombëtare. Në këto raste, plani duhet të përballet me ndryshime të thella ose mund të jetë i nevojshëm hartimi i një plani të ri. Përgjatë zbatimit të planit, duhen analizuar në mënyrë të vazhdueshme faktorët kryesorë që impaktojnë në parashikimet dhe objektivat e vëna në plan, si zhvillimi i popullsisë, ndryshimet lidhur me konsumin dhe llojin e mbetjeve të gjeneruara nga industritë apo ekonomitë shtëpiake. Gjithashtu analizimi i këtyre faktorëve shërben për të vlerësuar programet dhe projektet në proces apo që priten të fillojnë.

17.1 Monitorimi

Ky plan duhet të parashikojë hapat në vazhdim, indikatorët dhe mjetet për të vlerësuar punën e bërë, për të verifikuar nëse objektivat janë përmbushur dhe të raportimin tek vendimmarrësit. Qëllimi është që të sigurojë që autoritetet përgjegjëse u është dhënë mundësia për të ndjekur zhvillimin dhe zbatimin e planit dhe të vendosin mbi masat shtesë, nëse është e nevojshme. Studimi bazë, i kryer për qëllim të këtij plani, do të shërbejë si një status bazë mbi të cilën do të vlerësohen arritjet e objektivave dhe targeteve dhe mbi të cilat do të matet ndryshimi i indikatorëve të performancës së planit.

Monitorimi i planit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm me vlerësime periodike dhe, nëse është e nevojshme mund të kërkojë rishikimin e objektivave dhe masave të planit. Monitorimi i planit do të shërbejë për:

1. Për të dhënë informacion të vazhdueshëm tek bashkëpunëtorët dhe grupet e interesit, mbi statusin e zbatimit të planit;
2. Për të analizuar statusin dhe për të vlerësuar efektivitetin e skemave të zbatuara;
3. Për të përshtatur, modifikuar ose forcuar skemat apo programet në proces, ose për të krijuar të reja më të përshtatshme apo të efektshme;
4. Për të mësuar, përditësuar dhe shpërndarë informacion dhe njohuri.

17.2 Si kryhet monitorimi dhe vlerësimi

Bashkia duhet të ndjekë këto hapa në kryerjen e procesit të monitorimit dhe të vlerësimit të planit, si më poshtë:

1. Rishikimi i situatës: Rishikimi i objektivave dhe synimeve, kontrolli nëse ato i përshkruajnë kontekstin real dhe vlerësimi i tyre me anë të indikatorëve;
2. Mbledhja e evidencave sasiore dhe cilësore që lidhen me mbetjet;
3. Analizimi i evidencave: Analizimi i të dhënave për të matur progresin, krahasimi i rezultateve me objektivat dhe synimet, kontrolli nëse objektivat janë arritur në një afat kohor të dëshiruar;
4. Dokumentimi i konkluzioneve
5. Ndarja dhe diskutimi i konkluzioneve: Gjetjet duhet të ndahen me palët e interesuara dhe domosdoshmërisht me vendimarrësit.

Kryetari i bashkisë duhet të ngarkojë një grup pune përgjegjës apo zyrtarë të caktuar, brenda stafit të bashkisë, me përgjegjësinë e monitorimit dhe vlerësimit të planit. Grupi i punës duhet të përfshijë zyrtarë të administrimit të mbetjeve, administrimi financiar, struktura të mjedisit dhe kontrollit të territorit dhe konsulentëve të jashtëm.

18. PLANI I VEPRIMIT

I. PLANI VEPRIMI

Objekti i Strategjik	Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
Përgatitja e kuadrit ligjor dhe rregullator lokal të menaxhimit të mjetëve në përputhje me kërkesat në nivel kombëtar	1.1.1 Miratimi i Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mjetëve Ngurta Bashkia;	Bashkia Dibrë, Këshilli Bashkiak	2025-2029
	1.1.2 Përditësimi i Rregullores Lokale të Menaxhimit të Mjetëve në kushtet e ndarjes së re administrative;	Bashkia Dibrë (Përgjegjësi i Shërbimeve, Dep. Juridik)	2025-2029
		Konsulentë të jashtëm & Ekspertë; Këshilli Bashkiak	
	1.1.3 Aprovimi i sanksioneve lokale dhe penalteteve për çështjet e mjetëve;	Bashkia Dibrë, (Përgjegjësi i Shërbimeve, Dep. Juridik, Drejtoria e menaxhimit financiar) Këshilli i Bashkiak	2025-2029
	1.1.4 Aplikimi i instrumentave të komunikimit dhe informimit të komunitetit rreth rregullave dhe penalteteve;	Bashkia Dibrë, (Përgjegjësi i Shërbimeve), Vullnetarët, OJQ, përfaqësues të komunitetit,	2025-2029
Parandalimi i ndotjes nga gjenerimi dhe depozitimi pa kriter të mjetëve	1.2.1 Informimi i komunitetit për të diferencuar mjetet e rrezikshme nga mjetet urbane si dhe detyrimet e tjera të prodhuesit të mjetëve;	Bashkia Dibrë, (Administratoret e NJA, Përgjegjësi i Shërbimeve), Shkollat, ARM, Donatorët dhe organizatat joqeveritare	2025-2029
rrezikshme (si dhe spitalore) në zbatim të legjislatcionit shqiptar	1.2.2 Krijimi i skemave efektive për grumbullimin e ndarë të mjetëve të rrezikshme (të ngjashme me skemat e reduktimit të mjetëve);	Bashkia Dibrë, (Përgjegjësi i Shërbimeve); ARM, ISHMPU, ISHSH Donatorët dhe organizatat -	2025-2029

		joqeveritare		
	1.2.3	Ruajtja e sigurtë në mënyrë të përkohshme e mbetjeve të rrezikshme (sipas rregullores për administrimin e tyre) derisa të sigurohet një zgjidhje rajonale apo kombëtare për trajtimin përfundimtar të tyre.	Bashkia Dibër, (Drejt. Shërbimeve publike) ARM, Donatorët dhe organizatat joqeveritare	2025-2029
Parandalimi i ndotjes nga gjenerimi i mbetjeve spitalore apo mbetjeve inerte dhe ndërtimore	1.3.1	Inspektimi dhe kontrolli i ndotjes urbane nga materialet inerte dhe ndërtimore, skeletet e makinave, etj, që nga gjenerimi, transporti deri depozitimin e tyre;	Bashkia Dibër, (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë), ISHMPU; Kompanitë e ndërtimit	2025-2029
	1.3.2	Projektim dhe ndërtim ose miratim të një venddepozitimi të përkohshëm për mbetjet ndërtimore dhe mbetje të tjera vëllimore brenda standarteve kombëtare;	Bashkia Dibër, (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i Shërbimeve); Këshilli i Bashkiak	2025
	1.3.3	Organizimi i tryezave lokale me industrinë e ndërtimit për të inkurajuar përdorimin dhe riciklimin e këtyre materialeve;	Bashkia Dibër (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i Shërbimeve); Industria e ndërtimit	2025-2029
	1.3.4	Hartimi i një rregullore për operimin e venddepozitimit për mbetjet ndërtimore dhe mbetje të tjera vëllimore. Përcaktimi i sanksioneve kundrejt gjeneruesve të mbetjeve në rast të mos menaxhimit të duhur të këtyre mbetjeve që ata gjenerojnë;	Bashkia Dibër, (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i Shërbimeve); Këshilli i Bashkiak	2025
	1.3.5	Monitorimi i rregullt i operimit të venddepozitimit të mbetjeve ndërtimore dhe vëllimore, si dhe monitorimi i prodhuesve të tyre në lidhje procedurën që ata ndjekin kur gjenerojnë këto lloj mbetjesh.	Bashkia Dibër, (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i Shërbimeve, Përgjegjësi i venddepozitimit të mbetjeve ndërtimore dhe voluminoze)	2025-2029

Forcimi i kooperimit ndër-institucional dhe për monitorimin mjedisor dhe koordinimin e masave për përmirësimin e tij	1.4.1	Krijimi i dhe miratimi i një strukture lokale të inspektorëve bashkiak në lidhje me mjedisin dhe mbetjet;	Bashkia Dibër, Këshilli Bashkiak	2025-2029
	1.4.2	Zbatimi i sistemit të monitorimit në të gjitha NJA të Bashkisë dhe aplikimi i sanksioneve kundrejt shkelësve të rregullave apo dëmtuesve;	Bashkia Dibër, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë);	2025-2029
	1.4.3	Përmirësimi i procedurave të licencimit mjedisor të ST në kooperim të ngushtë me strukturat e Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM) dhe ISHMPU;	Bashkia Dibër; ARM; ISHMPU	2025
	1.4.4	Koordinimi në nivel rajonal dhe me njësitë lokale fqinje për monitorimin dhe parandalimin e ndotjes nga mbetjet, apo organizimin e shërbimit apo përdorimit e përbashkët të infrastrukturës së mbetjeve;	Bashkia Dibër; Keshilli i Qarkut Diber, si dhe njësitë e tjera locale	2025-2029

Objektivi Strategjik	Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
Përmirësimi i shërbimeve të mbetjeve në Bashkinë Diber;	2.1.1 Riorganizimi i zonave të shërbimit të mbetjeve (ndarje e Bashkisë në tre zona shërbimi;	Bashkia Dibër; (Kryetari, z. Kryetari Drejtori i shërbimeve, Përgjegjësi i shërbimit të mbetjeve)	2025-2029
Ofrimi i shërbimeve eficientë dhe cilësorë;	2.1.2 Hartimi i dokumentave të tenderit për tre kontrata e reja, sipas tre zonave në të cilat do të ofrohet shërbimi. Hapja e tenderit, përzgjedhja e kompanive që do të ofrojnë shërbimin;	Bashkia Dibër; (Kryetari, z. Kryetari Drejtori i shërbimeve, Përgjegjësi i shërbimit të mbetjeve, Ekspertë të jashtëm, Zyra Jurike);	2025-2029
	2.1.3 Shtrirja e shërbimit në NJA në të cilat nuk ofrohej shërbimi i mbetjeve dhe konsolidimi i shërbimit në NJA të cilat kanë patur shërbim. Investim në infrastrukturë duke e përmirësuar atë, në sajë të nevojë të reja që ka Bashkia e re (blerje kontenierë dhe mjete teknologjike;	Bashkia Dibër; (Administratoret e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, zyra juridike dhe financave);	2025-2029
	2.1.4 Monitorimi i rregullt i shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në të tre zonat e mbetjeve (tre kontrata e shërbimit). Raportime të rregullta nga të gjithë aktorët e përfshirë në systemin e monitorimit në instancat vendimmarrëse të bashkisë. Përgatitja e raporteve ditore/javore dhe mujore të gjendjes së PGM për të gjitha NJA;	Bashkia Dibër, (Administratoret e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, kompanitë private);	2025-2029
	2.1.5 Prezantimi i skemave të ndarjes në burim në rrugët kryesore të qytetit dhe në shkollat 9 vjeçare dhe të mesme të qytetit (mbetje të njoma dhe të thata);	Bashkia Dibër, (Administratoret e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, kompanitë private);	2025-2029
	2.1.6 Aplikimi i infrastrukturës të përshtatshme për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të riciklueshme. Investim në kontenierë dhe mjete teknologjike të posaçme për grumbullimin e këtyre mbetjeve;	Bashkia Dibër, (Administratoret e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, zyra juridike dhe financave,	2025-2029

		kompanitë private);	
2.1.7	Projektimi dhe ndërtimi i një pike grumbullimi për mbetjet e riciklueshme, e cila do të shërbejë për të pritur dhe paketuar mbetjet që vijnë nga zonat pilot të grumbullimit të ndarë të mbetjeve në qytetin e Peshkopisë;	Bashkia Dibër , (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, kompanitë private, Këshilli Bashkiak);	2025-2029
2.1.8	Prezantimi i skemave të kompostimit të mbetjeve të biodegradueshme në NJA Rrethinat dhe NJA	Bashkia Dibër , (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, kompanitë private);	2026-2029
2.1.9	Aplikimi i infrastrukturës të përshtatshme për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të të biodegradueshme. Investim në kontenerë dhe mjete teknologjike të posaçme për grumbullimin e këtyre mbetjeve;	Bashkia Dibër , (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, zyra juridike dhe e financave, kompanitë private);	2026-2029
2.1.10	Projektimi dhe ndërtimi i dy pikave të hapura për kompostimin e mbetjeve të biodegradueshme dhe kontrolli i vazhdueshmë i këtyre pikave;	Bashkia Dibër , (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, kompanitë private, Këshilli Bashkiak);	2025-2029
2.1.11	Me anë të mjeteve të informimit dhe komunikimit të bëhen transparent për publikun kostot e shërbimeve të pastrimit sipas kontratave si dhe detyrimet, ndalimet, rregullat si dhe një informacion specifik rreth shërbimeve, orareve, iniciativave, etj.	Bashkia Dibër , (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, kompanitë private);	2025-2029

Objekti	Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
Strategjik			
Rehabilitimi i të gjitha vend depozitimeve të vjetra në të gjitha NJA të Bashkisë Dibër	3.1.1 Kryerja e një studimi fizibiliteti për rehabilitimin dhe mbylljen e vendgrumbullimeve në NJA;	Bashkia Dibër; (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i shërbimeve publike), MTM, Ekspertë& Konsulentë të jashtëm	2025
	3.1.2 Sigurimi i financimit për zbatimin e projektit të rehabilitimit;	Bashkia Dibër;(Administratorët e NJA, Përgjegjësi i shërbimeve publike), MTM, Ekspertë& Konsulentë të jashtëm	2025
	3.1.3 Rehabilitimi i venddepozitimeve në NJA (sipas projektit);	Bashkia Dibër;(Administratorët e NJA, Përgjegjësi i shërbimeve publike), MTM, Ekspertë& Konsulentë të jashtëm	2025
	3.1.4 Hartimi dhe miratimi i një plani mjedisor të monitorimit dhe kujdesi pas mbylljes.	Bashkia Dibër;(Administratorët e NJA, Përgjegjësi i shërbimeve publike), MTM, Ekspertë& Konsulentë të jashtëm	2025
Monitorimi i vazhdueshëm i venddepozitimit	3.2.1 Lobim institucional pranë qeverisë qendrore (MIE&MTM) për financimin e projektit të ndërtimit të nje landfilli	Bashkia Dibër	2025-2029
	3.2.2 Monitorimi i rregullt i të gjitha dërgesave të mbetjeve që hyjnë në landfill, kontrolli i ngarkesës në lidhje me kategorinë e mbetjeve që duhet të lejohet të hyjë në landfill, raportimi i rregullt i ngarkesave të mbetjeve që hyjnë në venddepozitim	Bashkia Dibër;(Administratorët e NJA, Përgjegjësi i shërbimeve publike,	2025-2029

Objekti Strategjik	Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
Promovimi i ndarjes dhe minimizimit të mbetjeve në burim si dhe në të gjitha stadtet e gjenerimit të tyre duke aplikuar skema të përshtatshme pilot;	4.1.1 Mobilizimi i përfshirjes së komunitetit në skemat pilot, bërja e anketimeve paraprake për vlerësimin e vullnetit për t'u përfshirë para se të përzgjidhen zonat e dëshiruara; 4.1.2 Hartimi i një plani-pune specifik për zbatimin e skemave të ndarjes së mbetjeve, i cili duhet të koordinohet me sistemin ekzistues të grumbullimit të mbetjeve të tjera urbane; 4.1.3 Krijimi dhe zbatimi i skemave pilot të riciklimit dhe kompostimit të shtëpi sipas skemave pilot të rekomanduara në këtë plan;	Bashkia Dibrë, OJF, Komuniteti, vullnetarë, Bashkia Dibrë, (Përgjegjësi i shërbimeve, ekspertë të jashtëm Bashkia Dibrë Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit, Komuniteti	2026-2029 2026-2029
Progresi drejt objektivave kombëtarë për minimizimin e mbetjeve në nivel lokal.	4.1.4 Organizimi i takimeve në komunitet dhe me biznese, para dhe gjatë fillimit të skemave pilot për të mbështetur përpjekjet/programet e ndërgjegjësimit dhe edukimit për rritur cilësinë dhe nivelin e përfshirjes së komunitetit; 4.1.5 Organizimi i takimeve me grupet e interesit në rajon dhe me gjerë. Reklamimi i faciliteteve ricikluese si dhe skemave të grumbullimit të diferencuar, skemave të kompostimit;	Bashkia Dibrë , Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit, Komuniteti Bashkia Dibrë, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit, Shoqata e Bashkive	2026-2029

Stimulimi dhe mbështetja e sektorit privat lidhur me aktivitetet e riciklimit dhe kompostimit	4.1.6	Monitorimi i zbatimit të skemave të ndarjes së mbetjeve, riciklimit dhe kompostimit: efektivitetit dhe cilësisë së funksionimit ashtu dhe sasisë së mbetjeve që ndahet dhe përpunohet; Mbatja e një regjistri javor për këto të dhëna dhe relativimi çdo muaj pranë grupit mbikqyrës në bashki;	BashkiaDibër , Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit	2026-2029
	4.1.7	Lidhja e marrvëshjeve bashkëpunimi/pjesëmarrje me bizneset e mëdhenj ashtu dhe nëse është e mundur me komunitetin e skemave pilot për detyrimet dhe përfitimet e palëve;	BashkiaDibërEkspertë, bizneset e mëdhenj të qytetit, konsumatorët e skemave pilot	2026-2029
	4.1.8	Kryerja e studimeve të fizibilitetit dhe analiza ekonomike mbi zhvillimin lokal të kompostimit në nivel lokal ose ndër-lokal.	BashkiaDibër, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm;	2026-2029
	4.2.1	Inkurajimi i shtrirjes së skemave të riciklimit dhe kompostimit në shtëpi përmes bashkë-financimit me bizneset e riciklimit dhe komunitetin;	BashkiaDibër, Ekspertë & Konsulentë të jashtëm; biznese të riciklimit në rajon	2026-2029
	4.2.2	Promovimi dhe zhvillimi i tregjeve lokale për materialet e riciklueshme.	BashkiaDibër, Ekspertë të jashtëm; biznese të riciklimit në rajon	2026-2029

Objekti Strategjik	Veprimet e detajuara	Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë	Afatet kohore
Forcimi i kuadrit financiar të menaxhim të mbetjeve, marrvëshjeve dhe kontratave;	5.1.1 Aplikimi çdo vit i metodologjisë së "Llogaritjes së plotë të koston sipas modelit të DLDP " kur shpenzimet kapitale vlerësohen dhe llogaritet përgjatë gjithë jetës së dobishme të makinave dhe kontenerierëve;	Bashkia Dibrë (Përgj. Shërbimesh, dhe Dep. për Manaxhimin dhe Hartimin e Programeve Financiare-DMHPF)	2025-2030
Krijimi një sistemi financiar të përmirësuar (lidhur me buxhetin, investimet e nevojshme)	5.1.2 Rritje progresive e buxhetit vjetor operacional+mirëmbajtjes drejt mbulimit total të kostove operacionale dhe koston kapitale;	Bashkia Dibrë (Përgj. Shërbimesh, dhe Dep. DMHPF), Këshilli Bashkiak	2025-2030
	5.1.3 Kompesime financiare për konsumatorët me pamundësi për të paguar (me asistencë sociale apo me të ardhurave të ulëta) dhe jo për grumbullim inefficient të tarifave;	Bashkia Dibrë (Përgj. Shërbimesh, dhe Dep. DMHPF), Këshilli Bashkiak	2025-2030
	5.1.4 Hartimi i projekteve konkrete dhe të kërkohet mbështetje financiare për investimet e mëdha nga fondet e qeverisë, donatorë, hua nga institucione financiare apo banka;	Bashkia Dibrë Këshilli Bashkiak	2025-2030
	5.1.5 Rifreskimi i bazës së të dhënave të konsumatorëve duke synuar rritjen e numrit të tarifë paguesve drejt mbulimit total;	Bashkia Dibrë (Policia Urbane, Përgj. Shërbimesh, dhe Dep. MHPF), Këshilli Bashkiak	2025-2029
	5.1.7 Aplikimi i penaliteve të qarta efektive, dhe procedurave detyruese për mos pagimin e tarifave të mbetjeve;	Bashkia Dibrë (Policia Urbane, Insp. Shërbimesh, Këshilli Bashkiak	2025-2029
	5.1.8 Vendors stimuj për minimizimin, riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve: Aplikimi i uljeve në tarifat dhe heqja e tyre për konsumatorët e përfshirë në programet pilot të minimizimit;	Bashkia Dibrë (Përgj. Shërbimesh,, Këshilli Bashkiak	2025-2028
	5.1.9 Rishikimi dhe përmirësimi i tarifimit të bizneseve, në përputhje të plotë me parimin "ndotësi paguan";	Bashkia Dibrë (Përgj. Shërbimesh,, Këshilli Bashkiak	2025-2028
	5.1.10 Kryerja e studimeve periodike (vjetore) mbi "Dëshirën për të paguar" dhe "Mundësinë për të paguar" nga qytetarët;	Bashkia Dibrë (Dep. MHPF, Shërbimeve), Vullnetarë	2025-2029

5.1.11	Rishikimi i strategjisë së mbulimit të kostove dhe nivelit të tarifave, bazuar në analizën e zhvilluar në plan dhe marrja në konsideratë e performancës së grumbullimit, studimin e dëshirës për të paguar, kostove dhe objektivave si dhe indikatorët financiar të përcaktuar në këtë plan;	BashkiaDibër(Dep.MHPF, Shërbimeve) Ekspertë të jashtëm	Insp.	2025-2029
5.1.12	Transparenca dhe komunikimi: Procesi i caktimit të tarifave duhet të jetë transparent dhe duhet t'i komunikohet siç duhet të gjitha palëve të përfshira: duke përdorur metodat e komunikimit në masë si dhe atë "derë më derë".	BashkiaDibër (Dep.MHPF, Shërbimeve), , Vullnetarë, OJQ	Përgj	2025-2030

6.1.8	Hartimi i programeve dhe fushatave "vijuese" të riciklimit për të përmirësuar cilësinë e ndarjes në burim përmes programeve të riciklimit;	BashkiaDibër ; Konsulentë & Ekspertë të jashtëm, Bizneset e riciklimit, Vulnetarë,	2025-2029
6.1.9	Hartimi dhe shpërndarja e udhëzuesve dhe ilustrimeve për riciklimin dhe kompostimin, për shkollat, bizneset, banorët.	BashkiaDibër; Konsulentë & Ekspertë të jashtëm të komunitetit, Bizneset e riciklimit,	2025-2029